

KALLARATI



**Ec ngado,
Kallaratin mos e harro!**

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 20-të i botimit, nr. 118, janar-qershor 2026
Çmimi 50 L, Websajt: www.kallarati.com;

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Lefter Hysaj
Ky numër u sponsortizua nga:
Andon Leskaj



MIRËMËNGJES NGA KALLARATI

Ka mëngjese që nuk nisin thjesht me dritën e diellit, por me dritën e kujtimeve. I tillë është mëngjesi në Kallarati, në vendlindje, atje ku çdo gur, çdo rrugicë, çdo pemë dhe çdo fllad mali të flet me gjuhën e shpirtit. Të zgjohesh në Kallarati do të thotë të ndjesh pranë vetes rrënjët, historinë, njerëzit e dashur dhe zërat e brezave që kanë kaluar nëpër këtë vend me mund, dinjitet e dashuri. Këtu mëngjesi ka aromën e tokës, freskinë e maleve, qetësinë e fshatit dhe madhështinë e një vendi që nuk harrohet kurrë, sado larg të na çojë jeta. Vendlindja nuk është vetëm vendi ku kemi lindur. Është streha e parë e kujtesës sonë, është emri që na ndjek pas në çdo hap, është malli që zgjohet sa herë përmendet Kallarati. Ajo mbetet ...

Faqe 2



21 MARS 2026 - NË KALLARAT RIVENDOSJET PLLAKA PËRKUJTIMORE

Kallarati, Kuç e Bolenë, Në lum' e zunë dyfëknë
Me iniciativën e degës së Shoqatës "Kallarati" Tiranë, u realizua vendosja e pllakës përkujtimore në nderim të qëndresës së fshatrave të Lumit të Vlorës – Kallaratis, Kuçit dhe Bolenës – ndaj pushtesve osmanë dhe Reformave të Tanzimatit.
Në këtë aktivitet morën pjesë banorë të Kallaratis dhe fshatrave përreth, përfaqësues të strukturave...

Faqe 6

SË SHPEJTI "FSHATI I DJEGUR" KALLARAT, QENDËR HISTORIKE



Faqe 7

ANDI MEÇAJ, PROMOVON LIBRIN POETIK "ÇELËSAT E VITEVE QË RRODHËN"



MË 11 QERSHOR 2026, NË VLORË U PROMOVUA LIBRI I RI POETIK I AUTORIT KALLARATAS ANDI MEÇAJ: "ÇELËSAT E VITEVE QË RRODHËN", SI DHE DISA NGA PIKTUARAT E TIJ (MENDIME DHE VLERËSIME RRETH LINBRIT DHE AUTORIT)

Faqe 14

TAKIM PAS 52 VITESH DJE NA BASHKOI SHKOLLA "MUMIN SELAMI", SOT NA BASHKON JETA

Faqe 24

MIRËMËNGJES NGA KALLARATI

Ka mëngjese që nuk nisin thjesht me dritën e diellit, por me dritën e kujtimeve. I tillë është mëngjesi në Kallarat, në vendlindje, atje ku çdo gur, çdo rrugicë, çdo pemë dhe çdo fllad mali të flet me gjuhën e shpirtit.

Të zgjohesh në Kallarat do të thotë të ndjesh pranë vetes rrënjët, historinë, njerëzit e dashur dhe zërat e brezave që kanë kaluar nëpër këtë vend me mund, dinjitet e dashuri. Këtu mëngjesi ka aromën e tokës, freskinë e maleve, qetësinë e fshatit dhe madhështinë e një vendi që nuk harrohet kurrë, sado larg të na çojë jeta.

Vendlindja nuk është vetëm vendi ku kemi lindur. Është streha e parë e kujtesës sonë, është emri që na ndjek pas në çdo hap, është malli që zgjohet sa herë përmendet Kallarati. Ajo mbetet gjithmonë një copë zemre, një amanet i heshtur që na thërret të kthehemi, të kujtojmë, të duam dhe të mos harrojmë.

Prandaj ky mëngjes nga Kallarati nuk është një përshëndetje e zakonshme. Është një përkulje me respekt para vendit të të parëve, para historisë, para njerëzve që i dhanë emër e nder këtij fshati. Është një urim i dalë nga shpirti për të gjithë kallaratasit, kudo që ndodhen: ta mbajnë gjallë dashurinë për vendlindjen, sepse njeriu pa rrënjë është si pema pa tokë.

Mirëmëngjes nga Kallarati i dashur, nga vendi ku zemra pushon, kujtesa zgjohet dhe shpirti gjen paqe.



BRIGADA V SULMUESE DHE KALLARATASIT NË PËRBËRJE TË SAJ

(Me rastin e 82-vjetorit të krijimit)

Brigada e Pestë Sulmuese u përrua më 20 janar 1944 në Bramushje të Tërbaçit, rrethi i Vlorës duke pasur një efektiv prej 960 partizanë të rreshtuar në 5 batalione. Bërthama e saj prej tri batalionesh ishte krijuar që më 28 nëntor 1943 në fshatin Gumenicë të Vlorës. Kjo brigadë zhvilloi shumë luftime e beteja kundër pushtuesve nga jugu në veri e deri në Kosovë.



Në Brigadën e 5-të Sulmuese u rreshtuan edhe 7 kallaratas, nga të cilët 4 dhanë jetën e u shpallën dëshmorë të atdheut.

1. Hasan Laze Qejvanaj, dëshmor
2. Nexhip Sheraj (Elezaj), dëshmor
3. Zyber Sheraj (Elezaj), dëshmor
4. Shuaip Sheraj (Elezaj), dëshmor.

Të tre vëllezërit Sheraj (Elezaj) me banim në Hysoverdh.

5. Ahmet Rait Karabollaj,
6. Hariz Goxhaj
7. Qamile Goxhaj (burrë e grua).

Lavdi Brigadës së Pestë Sulmuese!
Lavdi dëshmorëve të Kallaratit të kësaj brigade!

Lavdi heronjëve dhe dëshmorëve të brigadës së 5-të Sulmuese!

BRIGADA E GJASHTË SULMUESE DHE KALLARATASIT NË PËRBËRJE TË SAJ

Brigada VI Sulmuese “Hero i Popullit”, u formua në qytetin e Përmetit më 26 janar 1944. Në të u rreshtuan batalionet partizane “Asim Zeneli”, “Abaz Shehu”, “Baba Abazi” dhe “Naim Frashëri” me një efektiv prej 912 partizanë e partizane. Më pas në Brigadë u rreshtua edhe Batalioni “Zaho Koka.

Gjatë rrugës luftarake të Br. VI S në të u rreshtuan mbi 1700 partizanë. Ajo i shkaktoi armikut dhjetëra të vrarë e të plagosur.

Nga radhët e saj ranë dëshmorë 191 partizanë dhe 12 partizane.

Pjesë e këtij kontributi janë edhe kallaratasit e mëposhtëm, disa rënë edhe dëshmorë të atdheut.

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Avdul Demiraj, Dëshmor i Atdheut | 9. Numan Goxhaj, |
| 2. Hamza Qejvanaj, Dëshmor i Atdheut | 10. Mato Hoxhaj, |
| 3. Ilmi Boshaj, | 11. Mehmet Zhibaj, |
| 4. Sinan Xhemili (Tozaj), | 12. Xhemal Gjonaj, |
| 5. Mehmet Karabollaj | 13. Sefer Jovanaj, |
| 6. Çune Qejvanaj, | 14. Qazim Mataj |
| 7. Fuat Goxhaj, | 15. Çelo Karabollaj. |
| 8. Hamit Qejvanaj, | |



Lavdi jetës dhe veprës të partizanëve dhe dëshmorëve të kësaj brigade, e në veçanti atyre kallaratas!

7 MARS – DITA E MËSUESVE

Të dashur mësues kallaratas dhe të ardhur, kudo që ndodheni, aktivë apo në pension, që keni shërbyer ndër vite në shkollën 8-vjeçare “Mumin Selami” në Kallarat!

Të dashur mësues kallaratas që keni punuar ose vazhdoni të punoni anembanë Shqipërisë!

Në këtë ditë të shënuar për arsimin shqiptar, kryesia e Shoqatës “Kallarati” ju shpreh mirënjohjen dhe respektin më të thellë për përkushtimin, sakrificën dhe kontributin tuaj në edukimin dhe formimin e brezave.

Gëzuar 7 Marsin – Ditën e Mësuesit!

Kontributi juaj do të mbetet gjithmonë një vlerë e çmuar për Kallarat dhe për gjithë shoqërinë.



GËZUAR 8 MARSIN – FESTËN E NËNËS!

Në këtë ditë të shënuar të festës së Nënës, urimi ynë si shoqatë u drejtohet të gjitha grave, nënave dhe motrave kallaratase, si dhe mbarë grave shqiptare, kudo që ndodhen.

8 Marsi është një ditë që mbart respekt dhe dashuri të pafund për nënat tona, për ato që na dhanë jetë nga jeta e tyre, për ato që natën e bënë ditë për ne dhe na rritën me përkushtim e sakrificë, për ato që na gjenden pranë edhe kur jemi larg, sa herë zemrat tona dëshpërohen e shpirtrat tanë kërkojnë ngrohtësi.

Është dita kur të gjitha lulet e botës dhe të gjitha urimet shkojnë për nënat. E gjithë dashuria derdhet si një lumë mirënjohjeje, sepse ato janë dhe do të mbeten gjithmonë më të pazëvendësueshmet dhe më të shtrenjtat për çdo njeri.

Gëzuar festën të gjitha nënave dhe motrave tona!



5 MAJ – DITA E DËSHMORËVE

Më 5 maj, në “Ditën e Dëshmorëve” të Atdheut, përulemi me nderim të thellë para kujtimit të bijve dhe bijave më të mirë të Kallaraitit dhe të mbarë Shqipërisë, që dhanë jetën për lirinë, pavarësinë dhe dinjitetin e vendit.

Gjaku i dëshmorëve është themeli i lirisë sonë dhe amaneti i tyre mbetet detyrim për çdo brez: ta duam atdheun, ta nderojmë historinë dhe ta ruajmë me dinjitet kujtesën kombëtare.

Lavdi për jetë dëshmorëve të Kallaraitit dhe të mbarë Shqipërisë!

I përjetshëm qoftë kujtimi dhe vepra e tyre!



EDHE NË KALLARAT U PËRKUJTUAN DHE U NDERUAN DËSHMORËT E ATDHEUT

Edhe banorët e Kallaraitit, kujtuan më 5 maj dëshmorët e fshatit që dhanë jetën për çlirimin e vendit.

Me këtë rast pranë lapidarit në qendër të fshatit në emër të Bashkisë së Himarës dhe Organizatës së Dëshmorëve e të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të fshatit, familjeve të dëshmorëve dhe banorëve të fshatit, u vendosën kurora e buqeta me lule. Ishin të pranishëm edhe administratorja e Njesisë Administrative Horë - Vranisht, znj. Elena Memushaj dhe kryetari i këshillit të fshatit z. Bashkim Davacaj.

Më vonë ceremonia përkujtimore e “Ditës së Dëshmorëve” vijoi në një drekë të përbashkët pa dallim, të



banorëve të fshatit në restorantin në qendër të fshatit të familjes Hoxhaj.

Vlerësim e Mirënjohje gjithë atyre që dhanë jetën dhe kontributin për lirinë e atdheut!

Mirënjohje gjithë bashkëfshatarëve në Kallarait që morën pjesë në këtë përkujtim.

Lavdi për jetë dëshmorëve të Kallaraitit dhe të Shqipërisë!



NJË FOTO E RRALLË

Miku ynë, Ramadan Ferraj nga Brati, na ka dërguar një fotografi të rrallë. Sipas shënimit dhe shpjegimit të tij, personi në të majtë të fotos është Riza Ramadan Ferraj, xhaxhai i të atit Shyqos. Ndërsa personi në të djathtë, me kollaro, është “Heroi i Popullit” Mumin Selami. Në këtë periudhë, të dy kanë qenë studentë në Medresenë e Tiranës.

Siç tregon Ramadan, Riza Ferraj u aksidentua rëndë me makinë në Lushnjë, teksa kthehej për pushime në vendlindje së bashku me Muminin, dhe ndërroi jetë në spitalin e Lushnjës në vitin 1936.

Trupin e tij e solli në Brataj pikërisht Mumin Selami, ku u përcoll me nderime.

Kjo fotografi dëshmon, jo vetëm miqësinë e tyre si studentë, por edhe lidhjet e hershme me Kallaratin. I ati i Rizait, Ramadan Ferraj, nip në Kallarati, kishte trashëguar nga e ëma emrin e gjyshit hoxhë, Ramadan Hoxhaj, emër që, siç thotë vetë Ramadan, fatmirësisht u trashëguua më pas edhe prej tij.

Ndoshta ky detaj nuk është i njohur për të gjithë në Kallarati, ndaj po e ndajmë me respekt dhe mirënjohje.

Falënderojmë mikun tonë Ramadan Ferraj për këtë fotografi të rrallë dhe për sqarimet me vlerë historike që na ka dhënë.

Një foto që flet për miqësi studentore e krahinore, por edhe shok të një ideali.



31 MAJ 2026 – 65 VJETORI I NDARJES NGA JETA I “NËNË DUZES”

(15 GUSHT 1890 – 31 MAJ 1961)

Duze Bajrami, ose “Nënë Duzja”, siç u njoh me respekt në Labëri e më gjerë, mbetet një nga figurat e shquara të gruas antifashiste shqiptare, deputete në tri legjislatura të Kuvendit Popullor dhe nëna e “Heroit të Popullit”, Mumin Selami nga Kallarati.

Ajo lindi më 15 gusht 1890 në Bolenë, në familjen e Mingajve, dhe u martua në Kallarati me Selam Bajramin. Jeta e saj u lidh ngushtë me hallet, qëndresën dhe historinë e njerëzve të thjeshtë të Labërisë. Ngjarjet e mëdha që përjetoj Kurveleshi dhe gjithë Shqipëria, sidomos pushtimi fashist i vendit, ndikuan fuqishëm në formimin e saj atdhetar. Bisedat me të birin, Muminin, gjimnazistin e Tiranës, gjatë kohës kur ai ishte i internuar në Kallarati, ia forcuan bindjen se fashizmi ishte një e keqe e madhe për vendin dhe duhej luftuar me çdo sakrificë. Vrasja e të birit, Mumin Selamit në betejën e Topanasë, si dhe humbja e djalit tjetër, Hasanit, me studime në Egjipt, ishin plagë të rënda për zemrën e një nëne. Por Nënë Duzja nuk u thye. Dhimbjen e ktheu në forcë, lotin në qëndresë dhe humbjen në betim për liri.

Ajo u bë simbol i nënës labe që nuk mendonte vetëm për fatin e shtëpisë së saj, por për fatin e Shqipërisë. Me fjalën e saj të zjarrtë, me karakterin e fortë dhe me shembullin personal, Nënë Duzja përshkoi fshatra të shumta të Zonës së Parë Operative Vlorë–Gjirokastrë, duke frymëzuar nënat, gratë dhe popullin për të mbështetur Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ajo dinte të fliste thjesht, por me zemër; dinte të jepte kurajë në çaste të



vështira dhe të ngrinte moralin e njerëzve edhe atëherë kur lufta kërkonte sakrificë të mëdha. Figura e saj u bë e njohur jo vetëm si nëna e një heroit, por edhe si një grua me shpirt të madh, me besë, guxim, dinjitet dhe dashuri të pakufishme për atdheun. Ajo mishëronte virtytet më të mira të gruas labe: qëndresën, mençurinë, fisnikërinë, fjalën e peshuar dhe zemrën e



Hasan Selam Bajrami



Mumin Selami (Bajrami)

fortë përballë dhimbjes. Në tetor 1944, në Kongresin e Parë të Bashkimit të Gruas Antifashiste Shqiptare në Berat, Nënë Duzja mori pjesë si delegate e ish-qarkut të Gjirokastrës dhe u zgjodh anëtare e Këshillit të Përgjithshëm të BGASH-it. Ky ishte një vlerësim për kontributin e saj dhe për besimin që gëzonte ndër gratë dhe nënat shqiptare. Edhe pas Çlirimit, ajo nuk u tërhoq nga jeta shoqërore.

Ndonëse në moshë, ajo mori pjesë në rindërtimin e vendit, në aksione kombëtare dhe u bë shembull i përkushtimit qytetar. Në vitin 1950, kur u zgjodh deputete në legjislaturën e dytë të Kuvendit Popullor, ndodhej vullnetare në

hekurudhën Peqin–Elbasan, duke dëshmuar se për të fjala “atdhe” nuk ishte vetëm ndjenjë, por edhe punë, mund dhe sakrificë.

Nënë Duzja përfaqësoi me dinjitet gruan shqiptare dhe nënat e dëshmorëve edhe në delegacione jashtë vendit. Për veprimtarinë e saj atdhetare u nderua me dekorata e medalje nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Ajo u nda nga jeta më 31 maj 1961, duke lënë pas emrin e një gruaje burrëneshe, të fortë, të urtë e fisnike; një nëne që sakrifkoi shumë, por nuk u përkul; një atdhetareje që e deshi Shqipërinë me zemër dhe me vepra. Në nderim të figurës së saj, në qytetin e Vlorës sot një rrugë mban emrin “Duze Bajrami”, si shenjë kujtese dhe respekti për jetën, veprën dhe virtytet e kësaj nëne të madhe labe.

Shfrytëzuar librin “Enciklopedia e Kurveleshit” dhe “Historiku i Kallarait”

Më 17 janar, kujtojmë Heroin tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeun, me një poezi të poetit dhe shkrimtarit të njohur shqiptar nga Kallارات, Hiqmet Meçaj, krijuar në vitin 1965.

SKËNDERBEU

Shqipja që rri përmbi shkrep
Është ushtar i Skënderbeut.
Lumi që rrjedh ndënë shkrep
është ushtë e Skënderbeut...
Kush u tha, kush i dërgoi,
Shqipëri, o Shqipëri,
të luftonin kundër turkut,
kundër turkut osmanli?

Era që u fut në pyll
çon një lajm për Skënderbeun,
zogu që u ul në lis,
po këndon për Skënderbeun.
ç'pati era, ç'deshi zogu,
Shqipëri, o Shqipëri,
të këndonin nëpër degë
dhe të shkonin te Ai?

Ra ylberi që nga qielli,
Skënderbeu s'është më,
zogu ra nga degë e lisit,
Skënderbeu s'është më.
Ti i fute në legjenda,
Shqipëri, o Shqipëri,
i shpërndave nëpër vende,
ku ka shkelur këmba e tij.

1965



21 MARS 2026 - NË KALLARAT RIVENDOSET PLLAKA PËRKUJTIMORE

Kallارات, Kuç e Bolenë,
Në lum' e zunë dyfeknë

Me iniciativën e degës së Shoqatës "Kallارات" Tiranë, u realizua vendosja e pllakës përkujtimore në nderim të qëndresës së fshatrave të Lumit të Vlorës – Kallاراتit, Kuçit dhe Bolenës – ndaj pushtuesve osmanë dhe Reformave të Tanzimatit.

Në këtë aktivitet morën pjesë banorë të Kallاراتit dhe fshatrave përreth, përfaqësues të strukturave vendore dhe të shoqatës, ndër të cilët: kryetari i këshillit të fshatit z. Bashkim Davacaj, kryetari i Shoqatës "Kallارات" z. Kastriot Karabolli, kryetari i degës së Tiranës z. Bako Xhaferaj, Prof. Dr. Rami Memushaj, sekretari i shoqatës z. Hasan Mehmetaj, kryeredaktori i gazetës "Kallارات" z. Lefter Hysaj, si dhe ish mësues e drejtues të shkollës 9-vjeçare "Mumin Selami", znj. Çize dhe znj. Violeta Xhaferaj, së bashku me shumë banorë të tjerë.

Një vlerë e veçantë e këtij aktiviteti ishte pjesëmarrja e Prof. Dr. Perikli Qiriazit, gjeograf i njohur dhe ish dekan i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, i cili në fjalën e tij përgëzoi shoqatën për këtë nismë dhe vlerësoi rolin e saj në ruajtjen dhe përcjelljen e traditës dhe historisë sonë kombëtare te brezat e rinj.

Shoqata "Kallارات" shpreh mirënjohjen për të gjithë ata që kontribuan në realizimin e këtij projekti, në mënyrë të veçantë për gurëgdhendësin z. Agim Mataj për punimin me vlerë artistike dhe historike, si dhe për z. Ylli Breshanaj, familjen e Astrit Mataj, z. Lisandër Bego Mataj dhe të gjithë bashkëpunëtorët që mundësuan vendosjen e pllakës.

Ky akt përkujtimor është një dëshmi e respektit dhe përkushtimit ndaj historisë sonë, si dhe një thirrje për ruajtjen dhe përcjelljen e vlerave tona ndër breza.



SË SHPEJTI “FSHATI I DJEGUR” KALLARAT, QENDËR HISTORIKE

PËRMBLODHI: BESNIK GJONBRATAJ

Në datën 21 mars 2026, në Kallarat, në prani të banorëve dhe bashkëfshatarëve të ardhur nga qytetet e Vlorës dhe Tiranës, Kryetari i Fshatit dhe Kryetari i Shoqatës “Kallarati” nënshkruan kërkesën zyrtare drejtuar Bashkisë së Himarës, për dhënien e miratimit paraprak në kuadër të procedurës për shpalljen e Kallaratit të Vjetër me statusin “Qendër Historike”.

Kërkesa mbështetet në vlerat historike, kulturore dhe identitare të këtij fshati, i cili është djegur nga andartët grekë në vitin 1914 dhe përbën një dëshmi të rëndësishme të historisë dhe qëndresës së banorëve të zonës së Labërisë.

Kjo nismë zhvillohet në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, me synim njohjen institucionale, mbrojtjen ligjore dhe promovimin e kësaj pasurie me vlera të veçanta historike



PROF. DR. PERIKLI QIRIAZI PRONONCOHET MBI NISMËN PËR SHPALLJEN E “FSHATIT TË DJEGUR” – QENDËR HISTORIKE

Profesor dr. Perikli Qiriazhi, një ndër figurat më të shquara të gjeografisë shqiptare, i njohur si “dekani i gjeografëve shqiptarë”, më 21 mars 2026, i ftuar nga Profesor dr. Rami Memushaj, vizitoi Kallarat në kuadër të nismës për shpalljen e “Fshatit të Djegur” me statusin “Qendër Historike”.

Profesor Qiriazhi është autor i një sërë studimesh të rëndësishme mbi gjeografinë e Shqipërisë, trashëgiminë natyrore, rreziqet mjedisore dhe ligatinat, si dhe i shumë teksteve shkollore. Kontributi i tij në prezantimin e gjeografisë shqiptare në arenën ndërkombëtare është i njohur dhe i vlerësuar gjerësisht.

Gjatë vizitës në terren, duke parë nga afër gjërmadhat e Fshatit të Djegur, si dhe peizazhin e veçantë të malit të Bogonicës, profesori u shpreh se ky vend jo vetëm që e meriton plotësisht statusin “Qendër Historike”, por paraqet edhe vlera të jashtëzakonshme natyrore.

Nga këndvështrimi si gjeograf, ai theksoi se peizazhet e malit të Bogonicës, në veçanti Gryka e Honit, përbëjnë potencial për t’u shpallur “Monument Natyror”.

Gjithashtu, ai vuri në dukje ekzistencën e disa shpellave me interes të veçantë studimor, duke hedhur idenë që, nën kujdesin e tij, të organizohen ekspedita gjeografike nga Italia për eksplorimin e tyre.

Duke vlerësuar nismën e ndërmarrë nga komuniteti kallaras, Profesor Qiriazhi u



shpreh optimist se institucionet shtetërore do ta mbështesin këtë kërkesë, pasi shpallja e këtij territori si “Qendër Historike” do ta përfshijë atë në hartën e trashëgimisë kulturore dhe historike të vendit, duke rritur interesin turistik dhe duke sjellë përfitime për banorët e zonës.

Në emër të Kryesisë së Shoqatës “Kallarati”, të Këshillit të Fshatit dhe të gjithë kallarasve kudo që ndodhen, shprehim mirënjohjen për vizitën dhe vlerësimin e dhënë.

Me rastin e 22 marsit, ditëlindjes së tij të 82-të, i urojmë Profesorit: “Shëndet, jetë të gjatë dhe vijimësi në kontributin e tij të çmuar shkencor dhe intelektual”.

Nga këndvështrimi si gjeograf, ai theksoi se peizazhet e malit të Bogonicës, në veçanti Gryka e Honit, përbëjnë potencial për t’u shpallur “Monument Natyror”.

Gjithashtu, ai vuri në dukje ekzistencën e disa shpellave me interes të veçantë studimor, duke hedhur idenë që, nën kujdesin e tij, të organizohen ekspedita gjeografike nga Italia për eksplorimin e tyre.

INTERVISTË ME HISTORIANIN KALLARATAS, Z. LEFTER HYSAJ

Në kuadrin e nismës për shpalljen e Fshatit të Djegur, Kallarat, si “Qendër Historike”, një intervistë me historianin kallarratas z. Lefter Hysaj, realizuar më 21 mars 2026, gjatë një vizite që zhvilluam së bashku me një grup bashkëfshatarësh dhe miqsh në këtë hapësirë me vlera të veçanta historike dhe natyrore të Fshatit të Djegur.

Në intervistën e tij, profesor Lefteri vlerëson nismën e Shoqatës “Kallاراتi”, duke theksuar se, përveç rëndësisë historike të Fshatit të Djegur, edhe Mali i Bogonicës, së bashku me elementë të tillë si: Gryka e Honit, Guri me Hije dhe një sërë shpellash, përbëjnë pasuri të çmuara natyrore që meritojnë vlerësim dhe mbrojtje.

Në përfundim, ai jep një porosi të vlefshme për vijimin e kësaj nisme: “Çdo hap duhet të hidhet me kujdes dhe përgjegjësi”, duke sugjeruar ndër të tjera edhe vendosjen e dy stendave informuese në hyrje të Fshatit të Djegur, të cilat do t’i ofrojnë vizitorëve një orientim dhe njohje paraprake me këtë zonë historike.



INTERVISTË ME PROF. DR. RAMI MEMUSHAJ

Një nga figurat më të spikatura sot të Gjuhës Shqipe, Prof. Dr. Rami Memushaj, mbetet njëkohësisht edhe një nga bijtë më të përkushtuar të Kallaratit.

I lindur në këtë fshat me tradita patriotike, ai u rrit mes vështirësive të kohës, por me një vullnet të jashtëzakonshëm për dije, që e çoi deri në majat më të larta të shkencës shqiptare.

Për shumë dekada pedagog në Universitetin e Tiranës, studiues i palodhur dhe autor i mjaft librave e studimeve në fushën e gjuhësisë, ai ka dhënë një kontribut të çmuar në zhvillimin e mendimit shkencor shqiptar, në mbrojtjen e shqipes standarde dhe në formimin e brezave të tërë studentësh brenda dhe jashtë vendit.

Një vend të veçantë në veprimtarinë e tij zënë edhe studimet historike, ku spikasin botimet si “Historiku i Kurveleshit” dhe “Himara”, si dhe kontributi si bashkëautor në “Enciklopedinë e Kurveleshit”, duke dhënë një ndihmesë të rëndësishme në pasurimin e historiografisë së krahinës dhe më gjerë.

Një kontribut të veçantë ai ka dhënë edhe për vendlindjen e tij. Nën drejtimin e profesor Ramiut është përgatitur Historiku i Kallaratit, si dhe një libër me përmbledhje krijimesh folklorike të rapsodëve kallarratas, tashmë gati për botim, duke pasuruar më tej trashëgiminë kulturore dhe kujtesën historike të fshatit.

Në mbështetje të nismës për shpalljen e “Fshatit të Djegur” si Qendër Historike, falë autoritetit dhe njohjeve të tij, ai ka angazhuar edhe mjaft figura të njohura të botës akademike e shkencore. Një shembull domethënës ishte sjellja në Fshatin e Djegur më 21 mars të këtij viti të Prof. Dr. Perikli Qiriazit, një personalitet i shquar i gjeografisë shqiptare dhe një mbështetës kryesor i kësaj nisme të rëndësishme.

Por përtej fushës akademisë, profesor Ramiu mbetet gjithmonë pranë Kallaratit. Me ide, shkrime dhe angazhim konkret, ai vijon të japë prej vitesh kontribute të vlera për shoqatën “Kallاراتi” dhe gazetën me të njëjtin emër, duke ndihmuar në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor të komunitetit.

Në këtë intervistë, realizuar më 21 mars 2026 në Fshatin e Djegur, ashtu si edhe profesor Perikli Qiriazit dhe historiani Lefter Hysaj edhe profesor Rami Memushaj ndan mendimet e tij mbi vlerat historike e kulturore të Fshatit të Djegur e malit të Bogonicës dhe rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë sonë për brezat që vijnë.

Në mbështetje të nismës për shpalljen e “Fshatit të Djegur” si Qendër Historike, falë autoritetit dhe njohjeve të tij, ai ka angazhuar edhe mjaft figura të njohura të botës akademike e shkencore. Një shembull domethënës ishte sjellja në Fshatin e Djegur më 21 mars të këtij viti të Prof. Dr. Perikli Qiriazit, një personalitet i shquar i gjeografisë shqiptare dhe një mbështetës kryesor i kësaj nisme të rëndësishme.



FALEMINDERIT MYZAFER QEJVANI!

“Ka njerëz që nuk bëjnë zhurmë,
por lënë gjurmë...”

I tillë është edhe Myzafer Qejvani (Myzua) — gjithmonë i gatshëm, pa u menduar dy herë, për t'i dalë në krah Shoqatës “Kallarat” në çdo aktivitet në Fshatin e Djegur. Jo vetëm me pjesëmarrjen e tij, por edhe me kontribut konkret, duke vënë në dispozicion makinën e tij për të sjellë miq e dashamirës, si në rastin e fundit me profesor Perikli Qiriazin dhe Rami Memushajn.

Por Myzua është edhe më shumë se kaq... Ai është një rrëfim më vete.

Si njohës i rrallë i malit të Bogonicës, ai



njih çdo shteg, çdo gur e çdo emër vendi, sikur i ka në pëllëmbë të dorës. Dhe ndërsa udhëton me të, nuk ndjen lodhje — sepse rruga mbushet me histori: nga mali i vendlindjes, tek rrugët e gjata të Amerikës, nga maunet e mëdha, tek kujtimet e jetës së tij plot përvojë.

Në të njëjtin njeri bashkohen dy botë, por zemra mbetet gjithmonë në Kallarat.

Dhe kështu, një rrugë e vështirë bëhet e lehtë, një udhëtim bëhet përjetim, sepse në timon është Myzua.

Faleminderit, Myzo për zemrën, për përkushtimin dhe për shembullin që jep çdo herë.

Nga Besnik Gjonbrataj



KUR ORIGJINA NUK HARROHET

Pjesëtarë të fisit Zeqaj nga Borshi, në një ndalesë në Kallarat, në fshatin e origjinës të të parëve të tyre.

Faleminderit që nuk i humbisni rrënjët Tuaja!

Me ju ndihemi krenarë të gjithë!

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ: NISMË ME VLERA HISTORIKE DHE KULTURORE QË DUHET MBËSHTETUR

(Shpalljen “Qendër Historike” të Fshatit të Djegur Kallarati)

Është i njohur në Lumin e Vlorës Kallarati dhe bashkë me të edhe “Fshati i Djegur” nga andartët grekë në vitin 1914. Banorët e Tij në atë mot, nuk u vendosën më aty, por e lanë si një dëshmi të kohës, për t’u parë dhe për t’u vizituar nga brezat që do të vijë. E fshati i djegur dhe rrënojat e tij flasin shumë dhe kanë mësuar breza të tëer rreth historisë, qëndresës së banorëve, por dhe arkitekturës të ndërtimit të shtëpive një shekull e ca më parë.

Në këtë vend, sot kanë mbetur veç rrënojat, por historia është atje dhe kjo histori duhet njohur nga brezat e rinj. Më ka rënë rasti ta vizitoj dy herë dhe jam befasuar nga ky fshat i rrënuar nga pushtuesit grekë. Kam shkruar dhe janë shprehur se ky vend meriton një status të mbrojtur nga shteti dhe nga institucionet e trashëgimisë kulturore.

Edhe pse me vonesë, sepse kanë kaluar mbi 111 vite nga djegja e tij dhe degradimi i ndërtesave ka ardhur në rritje, prapë duhet menduar se nuk është kurrë vonë për ta mbrojtur atë çfarë ka mbetur dhe për të kujtuar historinë e tij, tek brezat që vijnë dhe si një dëshmi orgjinale e luftërave dhe të djegjeve masive që pushtuesi u bënë fshatrave të Shqipërisë së Jugut.

Edhe unë kam përkrahur grupin e punës të shoqatës “Kallarati” me Prof. dr. Rami Memushaj në krye, i cili, pas konsultimeve me specialistë dhe autoritete të fushës së njohjes e ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore në Shqipëri, përgatiti një kërkesë. Kjo kërkesë ju është drejtuar institucioneve shtetërore të trashëgimisë kulturore, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës si: shkrime në shtypin vendas, pjesë nga historiku i fshatit dhe i Kurveleshit, emisione në TV, krijime letrare, harta, foto etj.

Duke qenë i njohur me miq në Kallarati, kam çmuar kontributin e këtij fshati dhe të banorëve të Tij, ndaj Labërisë dhe çështjes mbarë kombëtare, kam përkrahur kërkesën e përgatitur dhe gjithë dokumentacionin e përgatitur për shpalljen e Fshatit të Djegur, Kallarati “Qendër Historike” të dërguar institucioneve shtetërore prej Këshillit të Fshatit dhe Shoqatës “Kallarati”.

Unë jam i njohur me të gjithë materialin dhe shpresoj shumë në vendosjen e dinjitetit të kërkesës dhe në shpalljen “Qendër Historike” të Fshatit të Djegur Kallarati.



Mendoj se zëri i njerëzve të Kallaratit, por dhe zëri i mjaft miqve si dje dhe sot, të njohurve të Kallaratit do të jenë mbështetje dhe angazhim në këtë proces, si ndaj institucioneve vendimmarrëse, por edhe ndaj medias dhe rrjeteve sociale, të cilat kanë një rëndësi të madhe vlerësuese. Unë gëzohem për punën fisnike të bërë prej Tyre, edhe pse janë të vonuar, përsëri misioni është i saktë dhe gjithë materiali i përgatitur... unë mendoj, se pavarësisht aktit zyrtar, Kallarati e ka marrë që ditën e djegjes së fshatit statusin e Qendrës Historike. Të mënçuar kanë

qenë ata burra dhe gra që një zëri, ditën kur ju vu zjarri e u dogj Kallarati e lanë si një dëshmi historike të kohës.

Në Fshatin e Djegur të Kallaratit gjenden dhe sot dy varre të Smokthinjotëve. Është një histori e trishtë që duhet treguar, e cila dhe plotëson historinë e kohës, me tradita, norma dhe zakone, për të cilat populli dhe banorët i qëndronin burrënisë dhe kanunit.

Ishte koha që për të nderuar zakonet, besnikërinë, burrëninë, mikpritjen, besën dhe nderin e truallit, për t’i provuar botës që parësia nuk

fitohet e nuk mbahet vetëm me të drejtën e lindjes fisnike, shumë burra lanë jetën e tyre, shkatërruan shtëpi edhe fëmijët e vet, për namin dhe nderin e shtëpisë së tyre.

Me Kallaratin Smokthinën e lidh dhe një ngjarje historike. Eqerem bej Vlora e ka trajtuar ngjarjen në kujtimet e veta. Por ngjarja ka ardhur dhe deri në ditët tona, e për këtë flasin dy varre të smokthinjotëve në Kallarati.

Kujtesa historike shkurt. Pas rënies së Ali Pashës, më 1822, iku nga Janina edhe sejmieni i tij, Hysen Memo Rojta. U nis për të ardhur në Smokthinë. Shkoi në Kallarati në shtëpinë e Toto Qejvanit, të cilin e kishte nip. Smokthinjotët shkuan për të marrë hak ndaj luftimeve të bëra në Ramicë, për dorëzimin e Ibrahim Pashës së Beratit që ishte strehuar tek Zoto Aga Mahmuti. Kullat e Zotos u bombarduan me topa të vegjël, u vranë rreth 23 burra nga fisi i këtyre trimave, Ibrahim Pasha u dorëzua dhe Zoto Mahmuti e Mustafa Agaj u vranë në Ujë të Ftohtë, Vlorë.

...Në Kallarati, shkuan një grup i madh me djem nga Ramica e Velça dhe rrethuan shtëpinë ku ishte strehuar. Hysenji u premtoi pare e florin, por smokthinjotët nuk pranuan dhe e vranë Hysenin dhe djalin e tij. Ata nuk i pranuan gjithashtu të varroseshin në Smokthinë. Ata e varrosën në Kallarati.

Të afërmit e tyre kërkuan pas 150 vitesh për të marrë eshtrat e tyre dhe për t’i prurë në Smokthinë, por drejtuesi i kohës i Smokthinës, ju përgjigj se nuk ishte në dorën e tij. Për këtë vendim të marrë para 150-vitesh duhej pyetur e gjithë Smokthina. Problemi nuk u ngacmua më... varret janë dhe sot në Kallaratin e djegur.

Është kjo dhe një histori sa tragjike, aq dhe burrërore e fisnike e cila tregon vlerat e kohës dhe burrërinë e fjalës. Ata dy varre flasin për një histori të madhe të krahinës, e cila luftonte dhe jetonte me dinjitet dhe fisnikëri. Zakonet, normat, doket dhe trimëria çmohej dhe vlerësohej sa një mijë kushtetuta së bashku.

Fjalën e kisha se ka ç’ të tregohet histori në Fshatin e Djegur të Kallaratit. Gjithë zona ka lidhje me këtë fshat dhe historitë, miqësitë, luftërat, përpjekjet ishin të përbashkëta, e në këtë mes shpallja e fshatit “Qendër Historike” do të jenë nder për gjithë Lumin e Vlorës, por dhe për Brgedetin e Kurveleshin. Historitë do të rrëfejnë njera tjetren...





PIKNIKU PRANVEROR NË FSHATIN E DJEGUR – KALLARAT

Një ditë kujtese, bashkimi, tradite dhe dashurie për vendlindjen



NGA BESNIK GJONBRATAJ

Më 24 maj 2026, në një ditë të bukur pranvere, në mjedisin historik dhe natyror të Fshatit të Djegur në Kallarat, u zhvillua edicioni i tretë i Piknikut Pranveror, një veprimtari që tashmë po kthehet në një traditë të dashur për kallaratasit, miqtë dhe dashamirësit e Kallaratit.

Që në orët e para të ditës, rruga drejt Fshatit të Djegur mori gjallëri. Bashkëfshatarë nga Kallarat, Vlora, Tirana dhe qytete të tjera, familje të tëra, të rinj, fëmijë, miq e dashamirës, u ngjiten drejt këtij vendi të shenjtë të kujtesës sonë historike, për të kaluar një ditë ndryshe, mes natyrës, historisë, këngës, valles dhe bisedave të ngrohta njerëzore.

Fshati i Djegur, ky vend që ruan në heshtje gjurmët e një historie të dhimbshme, por edhe



krenare, u mbush sërish me zëra, me këngë, me buzëqeshje dhe me jetë. Aty ku dikur flasin gurët, rrënojat dhe kujtesa e të parëve, sot u dëgjua zëri i brezave që rikthehen me mall, respekt dhe dashuri për rrënjët e tyre.

Pjesëmarrësit u mblodhën në një atmosferë të lirë, miqësore dhe festive. Nuk ishte thjesht një piknik në natyrë, por një takim shpirtëror me vendlindjen, një rikthim në hapësirat ku historia, tradita dhe kujtesa bashkohen natyrshëm.

Fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit u bënë pjesë e një dite që kishte brenda saj gëzim, mall, krenari dhe mirënjohje.

Një hijeshi të veçantë kësaj dite i dhanë veshjet me kostume popullore, sidomos ato të fëmijëve dhe të rinjve. Ngjyrat, qëndisjet dhe bukuria e kostumeve tradicionale sollën para syve trashëgiminë e pasur kulturore të Labërisë dhe të Kallaratit. Ato nuk ishin vetëm veshje festive, por dëshmi e një identiteti që ruhet, përcillet dhe nderohet brez pas brezi.

Gjatë zhvillimit të piknikut nuk munguan këngët labe, vallet, përshëndetjet, bisedat e përzierme dhe çastet e gëzuara familjare. Kënga, si gjithmonë, zuri vendin e saj të natyrshëm në këtë mjedis. Në Fshatin e Djegur, aty ku mali, guri dhe historia duket sikur dëgjojnë, kënga labe mori një tingëllim të veçantë. Ajo u bë zëri i kujtesës, i krenarisë dhe i bashkimit.

Mikrofoni ishte i lirë për këdo që dëshironte të përshëndeste, të jepte një mesazh, të ndante një kujtim apo të shprehte dashurinë për Kal-



laratin. Kjo i dha veprimtarisë një frymë të ngrohtë dhe gjithëpërfshirëse, ku secili ndihej pjesë e saj, jo vetëm si pjesëmarrës, por edhe si bashkorganizator shpirtëror i kësaj dite.

Një vend të rëndësishëm gjatë kësaj veprimtarie zuri edhe promovimi i vlerave historike, kulturore dhe turistike të Kallararit. Pikniku Pranveror në Fshatin e Djegur nuk është vetëm një takim argëtues, por edhe një formë e bukur ndërgjegjësimit për rëndësinë e këtij vendi, për ruajtjen e kujtesës historike dhe për nismën e shpalljes së tij “Qendër Historike”.

Pjesëmarrja e gjerë dhe dashuria që treguan kallarratasit për këtë vend janë një dëshmi e qartë se Fshati i Djegur nuk është thjesht një hapësirë gjeografike. Ai është pjesë e ndërgjegjes sonë të përbashkët, është kujtesë, është amanet, është histori dhe krenari.

Prandaj, çdo veprimtari që zhvillohet aty merr një kuptim më të thellë dhe bëhet një hap më shumë drejt njohjes, mbrojtjes dhe promovimit të vlerave të tij.

Për zhvillimin sa më normal të kësaj dite u morën edhe masa paraprake, veçanërisht për përmirësimin e pjesshëm të rrugës që të çon drejt Fshatit të Djegur, me qëllim lehtësimin dhe sigurinë e lëvizjes së mjeteve. Për këtë, meritojnë falënderim të gjithë ata që kontribuan, institucionet vendore, administratorja e Njësisë Administrative, Bashkia Himarë, Këshilli i Fshatit, Kryesia e Shoqatës “Kallarati”, si dhe djemtë e fshatit që ndihmuan në përgatitjet dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë.

Pikniku Pranveror dëshmoi edhe një herë se Kallarati di të bashkohet rreth vlerave të veta. Ai tregoi se, pavarësisht vendbanimit, largësive dhe angazhimeve të përditshme, dashuria për vendlindjen mbetet e gjallë. Në këtë ditë, Fshati i Djegur u kthye në një vatër takimi, ku u bashkuan brezat, u forcuan lidhjet dhe u përcoll mesazhi i bukur: “Ec ngado, por Kallaratin mos e harro.”

Në fund, pjesëmarrësit u larguan me mbresa të bukura, me fotografi, kujtime dhe dëshirën për t’u rikthyer përsëri. Sepse një ditë e tillë nuk mbyllet vetëm me përfundimin e aktivitetit; ajo mbetet në kujtesë, në biseda, në fotografi dhe në zemrat e atyre që ishin të pranishëm.

Pikniku Pranveror në Fshatin e Djegur nuk ishte vetëm një ditë në natyrë. Ishte një ditë e Kallararit, për Kallaratin dhe me Kallaratin në zemër.



FALËNDERIM PËR FISIN JONUZAJ



Falënderojmë për zemërsisht fisin Jonuzaj të Kallararit, me banim në Penkovë, jo vetëm për pjesëmarrjen e tyre në Piknikun Pranveror në Fshatin e Djegur, por edhe për këngët e bukura që kënduan së bashku me djemtë e Kallararit, duke i dhënë kësaj dite më shumë gjallëri, emocion dhe frymë kallaratase.

Pjesëmarrja dhe kënga e tyre tregojnë më së miri se prejardhja, rrënjët dhe origjina nuk harrohen asnjëherë. Dashuria për vendlindjen mbetet e gjallë, edhe kur jeta të çon në vende të tjera.

Ashtu si fisi Jonuzaj, dashurinë për Kallaratin e ruajnë dhe e shprehin me respekt edhe familje të tjera me origjinë nga fshati ynë, siç janë edhe Zeqajt në Borsh, të cilët mbajnë të gjallë lidhjen shpirtërore me Kallaratin.

Kjo është pasuria jonë më e madhe: kujtesa, kënga, rrënjët dhe dashuria për vendlindjen.

Ec ngado, por Kallaratin mos e harro!

TRUPI NË KURBET, MENDJA NË ATDHE

- Poezi nga Riza Memushaj -

Shoqata Kallarati përgëzon me respekt autorin Riza Memushaj për këtë poezi të shkruar me ndjenjë, ku malli për Kallaratin dhe Atdheun vjen i gjallë, i pastër dhe prekës. Vargje zemre që bashkojnë mërgimin me rrënjët dhe na kujtojnë se, kudo që jemi, Kallarati jeton brenda nesh.

TRUPI NË KURBET,
MENDJA NË ATDHE

Trupi në kurbet
Mëndja në Atdhe
Fizikisht këtu
Shpirtërisht atje
Ku e nisa jetën
Edhe ku u rrita
Atje më rri mëndja
Përnatë e përdita
Edhe pse atje
Nuk kam asnjë pronë
Mëndja prapë se prapë
Atje më qëndron
Tridhjet e pesë vjet
Këtu në mërgim
Po në ëndërra shoh
Vetëm vendin tim



Këtu kam familjen
Këtu ha e pi
Po këtu një ëndërr
Skam parë der tani
Si ai zgalemi
Që shkon përmbi dete
Mëndja natë për natë
Tek linda më vete
Ku i hapa sytë
Dhe dola në jetë
Gjysmë e zemrës time
Atje më ka mbet
Ku pata shtëpinë
Që se kam më sot
Mëndja hergjele'
Atje më "kullot"

Kujtoj nënë e babë
Dhe tërë farefis
Vëndet ku kam loz
Dhe ku kam gjezdis
Herë "lahem" te ngjilli
Aty poshtë shtëpisë
Dhe më pas "vapoje"
Te shtrati nën lis
Më bëhet në ëndërr
Sikur "kalorj" lumin
Edhe më të dal
Opingat më humbin
Nganjëherë shikoj
Sikur del nga shtrati
Edhe më rrëmben
Po më shpëton fati

Herë si një dron
Mbi fshat fluturoj
Vëndet ku kam shkel
Nga lartë i vështroj
"Takohem" për natë
Me shokët e mi
Dhe pse të moshuar
Më duken fëmijë
Dhe ata që s'rrojnë
I gjej të "gjallë"
Si dikur të vegjël
Takohem me mall
E kam pyetur veten
Kushedi sa herë
Kjo që më ndodh mua
Ndodh dhe me të tjerë!

Më 11 qershor 2026, në Vlorë u promovua libri i ri poetik i autorit kallaratas Andi Meçaj: “Çelësat e viteve që rrodhën”, si dhe disa nga piktuarat e tij

ANDI MEÇAJ, PROMOVON LIBRIN POETIK “ÇELËSAT E VITEVE QË RRODHËN”

(Mendime dhe vlerësime rreth linbrit dhe autorit)



ARKITEKTURA E KUJTESËS DHE E KOHËS TE ANDI MEÇAJ

(Analizë tematike dhe stilistike e vëllimit: “Çelësat e viteve që rrodhën”)

NGA: ANILA TOTO,
VLORË MË 11 QERSHOR, 2026

Andi Meçaj është një bir i qytetit, i rritur në frymën e dy etapave të jetës që prezantojnë, 1. Vendlindja dhe kurbeti, 2. Piktura dhe poezia. Aty, imazhi piktoresk i detit, maleve, fushave dhe traditave historike takohet natyrshëm me fjalën poetike. Si pjesë e brezit të viteve '90, nxënës i shkollës “Naim Frashëri”, i ushqyer me një frymë krijuese moderne dhe surrealistike, ai ka formuar një profil të veçantë artistik, të karakterizuar nga thjeshtësia, humanizmi dhe qytetaria. Brenda vetes mbart trashëgiminë e penës, si bir i shkrimtarit të njohur vlonjat, z. Hiqmet Meçaj.

Andi Meçaj; tashmë i pavarur nga trashëgimia e tij, nuk bën thjesht poezi; ai dokumenton faktet, ndjenjat, strukturat e vjetra shoqërore shqiptare nëpër faktet reale të jetës, pa i zburuar ato.

Poezia e Andi Meçajt ka tejkaluar kufijtë lokalë. Përfshirja e tij në antologji rajonale dhe në tekste universitare dëshmon se përvoja individuale e migrimit, e tranzicionit del përtej kufijve gjeografikë dhe kulturorë.

Vëllimi poetik “Çelësat e viteve që rrodhën”, përfaqëson një udhëtim lirik nëpër labirintet e vetëdijes njerëzore. Poezitë ndërtojnë një plan



poetik ku kujtesa, koha, humbja, ekzistenca dhe identiteti ndërthuren natyrshëm me njëra-tjetrën. Udhëtime shpirtërore, ndjenja të brishta njerëzore, nevoja, braktisje, përditshmëri dhe përvoja jetësore bashkëjetojnë në një univers poetik të ngrohtë dhe thellësisht human.


Libri fillon me tre mendime të z. Sulejman Mato, Ardian Kycyku dhe Alisa Velaj.

Natyrisht, i anashkalova pak për të krijuar idenë time e më pas i lexova për të ballafaquar mendimet. Jam falënderuese për ato që lexova!

Njeriu, natyra dhe ndjenja përbëjnë trinomin themelor të këtij libri, duke e shoqëruar lexuesin në çdo poezi.

Vetë titulli: “Çelësat e viteve që rrodhën”, paraqitet si një metaforë e fuqishme dhe shumëplanëshe, e ndërtuar mbi dy simbole kryesore. “Çelësat”, përfaqësojnë mundësinë e hyrjes në kujtesë, të përvojave dhe të sekreteve të jetës, ndërsa: “vitet që rrodhën” shprehin kalimin e pandalshëm të kohës. Poeti na kujton se secili prej nesh mban brenda vetes çelësat e kujtesës dhe të identitetit, të gatshëm për të hapur dyer të së shkuarës.

Në poezinë e Andit, fjala shndërrohet në instrument kërkimi, në një lloj arkeologjie shpirtërore të kujtesës personale dhe kolektive. Prej kësaj kujtese ai nxjerr “çelësat” që ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë identitetin e vet, origjinën dhe raportin me



kohën. Kështu, poeti ndërton një poetikë të heshtjes, të paqes dhe të medimitit, ku njeriu kërkon vazhdimisht kuptimin e ekzistencës së tij.

Poezitë kalojnë nëpër stacione të ndryshme emocionale: nga trauma e emigrimit dhe reflektimi mbi tranzicionin shoqëror, te satira sociale, lirika intime, dashuria, kujtesa dhe meditimi filozofik mbi kohën dhe ekzistencën. Kjo lidhje temash e bën librin një mozaik përvojash njerëzore, ku individualja dhe kolektivja bashkëjetojnë në harmoni poetike.

Kontrastet e kohëve të jetës në poezinë e Andi Meçajt shprehen përmes elementeve ku hendeku midis së shkuarës dhe së tashmes merr formë artistike dhe emocionale. Fëmijëria shfaqet si një hapësirë e gjallë, e mbushur me ngrohtësi, siguri dhe përmasa të mëdha shpirtërore, ndërsa e tashmja vjen si një kohë reflektimi, mungese dhe ndryshimi.

Shkallët e jetës paraqiten përgjatë poezive si një proces i vazhdueshëm rritjeje dhe vetëdijësimi. Edhe pse vëllimi nuk është ndërtuar sipas një rendi kronologjik apo të shkallëzuar, poezitë lidhen mes tyre përmes ndjenjave, arkitekturës së ideve dhe përvojave që përcjellin, duke krijuar një biografi shpirtërore të poetit.

Autori mediton vazhdimisht mbi faktin se bota që e rrethon – lagjia, rrugët, objektet dhe shtëpia – marrin kuptim vetëm përmes njerëzve që i kanë banuar dhe jetuar në to. Pa praninë e tyre, muret mbeten dëshmitarë të heshtur të një kohe që ka humbur zërat, hapat dhe gjallërinë e dikurshme, duke u shndërruar në kujtime. Aty janë shtyllat kryesore antropologjike ku mund të mbështetet analiza e poezisë së tij:

Vargjet: “I vogël, shtëpia më dukej e madhe / i madh, shtëpia më ngjan e vogël”, funksionojnë si një përshkrim i hulumtimit antropologjik mbi ndryshimin e shkallës së ekzistencës së individit përballë mjedisit.

Rrugëkryqi te: “Nina-nana te rrugakryq”, është një vend klasik antropologjik: vendi mistik ku ndahen botët, ku merren vendimet ekzistenciale dhe ku njeriu ndihet i pambrojtur pa “yshtjet” apo mbrojtjet e të parëve.

Poezitë si “Kthimi”, “Pushime në atdhe” dhe “Kthimi në shtëpi”, analizojnë figurën e emigrantit apo të njeriut të zhvendosur, që përjeton atë që antropologët sot e quajnë gjendja midis dy botëve.

Në pjesën e dytë të vëllimit, poeti zhvendoset nga antropologjia familjare drejt antropologjisë urbane. “Doruntina sjell Kostandinin në shtëpi...”, edhe ky është një operacion letrar i pastër antropologjik.

Por, ne të gjithë vëllimin ndihet një nostalgji e thellë për gjërat që kanë humbur funksionin dhe energjinë e tyre jetësore: divanet e dërrmuar, muret që “rrijnë seriozë”, rrugët e heshtura, mungesa e njerëzve të dashur që kanë ndikuar në jetën dhe formimin shpirtëror të autorit. Këto figura nuk

paraqiten thjesht si elemente të kujtesës, por si pjesë përbërëse të identitetit të tij emocional.

Ky vëllim mund të lexohet dhe të analizohet në katër plane themelore: letrar, konceptual, mistik dhe kritik.

Në planin letrar, libri ndërtohet si një udhëtim poetik që nis nga hapësira intime e shtëpisë së fëmijërisë dhe e marrëdhënieve familjare. Poezitë krijojnë një rrjet simbolesh dhe figurash që bashkojnë të shkuarën me të tashmen.

Në planin konceptual vëllimi shfaqet si një arkeologji shpirtërore e kujtesës: Shtëpia e zanafilës, figura e nënës, familjes dhe e vendlindjes mbeten qendra gravitacionale rreth të cilave rrotullohet universi poetik i autorit.

Në planin mistik kujtesa fiton përmasa metafizike. Muret, objektet, stacionet, rrugët dhe qytetet shpirtëzohen dhe kthehen në qenie simbolike që mbartin energjinë dhe gjurmët e kohës. Kështu, realja dhe imagjinaria bashkëjetojnë në të njëjtën hapësirë poetike.

Në planin kritik Andi Meçaj ndërton një reflektim të heshtur mbi tjetërsimin e njeriut modern. Ai paraqet individin si një qenie të zhvendosur mes kohëve dhe ndjenjave, që përipiqet të ruajë iden-



titetin e vet përballë ndryshimeve të vazhdueshme të botës bashkëkohore.

Përmes një gjuhe të pasur me figuracion, simbolikë dhe personazhe të skalitur me kujdes, autori krijon një atmosferë të qetë, meditative dhe thellësisht humane. Pavarësisht problematikave të jetës, humbjeve, zhgënjimeve, largimeve apo

vetmisë, libri mbetet një himn për njeriun dhe aftësinë e tij për të dashur, për të kujtuar dhe për të vazhduar përpara.

Në thelb, poeti duket se na thotë se i do njerëzit që kanë kaluar në jetën e tij, ata që jetojnë ende pranë tij dhe ata që i ruan vetëm në kujtesë. Ai i pranon me dritat dhe hijet e tyre, pa i gjykuar, por pa harruar kurrë të mbrojtjeve dhe të ushqejve botën e vet të brendshme.

Të zymta mendimet e mia.

Pse s’qeshni?!

Të qeshur sytë e mi.

Pse qani?!

Qaj edhe ti, o rrugë,
për puthjet e grabitura,
e grabitur u gdhij edhe ëndrra.”

Qysh në këto vargje paraprilet atmosfera e përgjithshme e librit. Poeti ndërton një dialog të vazhdueshëm midis dritës dhe errësirës, midis kujtesës dhe humbjes, duke krijuar një univers ku ndjenja individuale shndërrohet në përvojë universale njerëzore.

Shiu në poezinë e Andi Meçajt funksionon si një element pastrues dhe çlirues. Përmes vargjeve nënkuptohet nevoja për t’u çliruar nga pesha e kujtimeve dhe për të gjetur paqe, qoftë brenda vetes, qoftë në ritmin e pandërprerë të piklave të shiut.

Në aspektin psikologjik, shiu shfaqet si një urë lidhëse midis qiellit dhe poetit. Ai perceptohet si një reflektim i lotëve të vetë autorit, duke krijuar një komunikim të heshtur mes botës së brendshme dhe natyrës. Ky raport mes ujit, qiellit dhe vetëdijes merr trajta mistike, sikur natyra komunikon me poetin përmes kodeve të saj sekrete.

“Shi i zymtë,
puthje të grabitura,
këmbët të trembura
që futen nën ombrellë.
Ç’bukuri e pabesueshme!”

Vargjet ndërtojnë një imazh të fuqishëm poetik dhe pamor, të mbushur me figuracion karakteristik për stilin e Andi Meçajt. Në krijimtarinë e tij vërehet një lidhje e natyrshme midis pikturës dhe poezisë. Sikurse piktori ndërton telajon me ngjyra, poeti ndërton tablotë e tij me fjalë. Lexuesi nuk përballet vetëm me tekstin, por me imazhe të gjalla që shfaqen para syve gjatë leximit. Kjo aftësi vizuale përbën një nga veçoritë më të dallueshme të poetikës së tij.

Në poezinë: “Atë ditë të bukur vere...”, gjendja emocionale e autorit paraqitet e lëkundur mes dritës dhe melankolisë. Megjithatë vera ka gjallëri dhe lumturi, poeti vazhdon të mbajë brenda vetes një ndjenjë mungese dhe mallëngjimi. Melankolia nuk paraqitet si dobësi, por si mënyrë për të kujtuar dhe përballuar jetën.

Ai kërkon dritën edhe aty ku ajo mungon, duke e shndërruar atë në një simbol të vazhdueshëm të shpresës. Drita, në formë të ndryshme, përshkon

të gjithë librin. Edhe kur nuk është e pranishme fizikisht, ajo ekziston si dëshirë, kujtim ose kërkim shpirtëror.

“Në çdo prekje,
në çdo orëndi,
në çdo dhomë
pashë fantazmat,
fantazmat e ikjes sime.”

Në rrafshin e kritikës letrare, ky vëllim operon si një thyerje e vetëdijshme e lirikës tradicionale përmes një gjuhe të mprehtë surrealistike dhe një strukture urbane. Poezia e Andi Meçajt karakterizohet nga një ngarkesë e fortë lirike, ku ndërthuren melankolia e natyrës dhe kontradiktat psikologjike të njeriut. Në këtë univers poetik, elementet tradicionale të zymtësisë marrin një kuptim të ri estetik, duke u shndërruar në forma të së bukurës.

“Të zymtat mendime të mia,
pse s’qeshni?!”
“Të qeshurit sytë e mi,
pse qani?!”

Vargjet ndërtohen mbi antitezën, personifikimin dhe pyetjen retorike. Këto figura krijojnë tension emocional i cili përshkon poezinë duke vendosur përballë njëra-tjetrës gëzimin dhe dhimbjen, dritën dhe errësirën.

Po kështu, në vargjet:

“Qaj edhe ti, o rrugë,
për puthjet e grabitura...”

Shfaqen njëherazi personifikimi, apostrofa dhe metafora. Rruga bëhet bashkëvruajtëse e poetit, ndërsa kujtesa e dashurisë së humbur projektohet mbi hapësirën urbane. Natyra dhe qyteti marrin pjesë në dramën emocionale të subjektit lirik.

Një kthesë interesante poetike vjen me figurën e parukieres Matildë. Ajo përfaqëson jetën e zakonshme qytetare, rutinën, bisedat dhe realitetin e përditshëm. Megjithatë, edhe ajo mbart brenda vetes një “ëndërr të grabitur”.

Përmes këtij detaji, poeti na kujton se dhimbja, mungesa dhe dëshirat e paplotësuara janë pjesë e përbashkët e përvojës njerëzore. Organet e trupit fitojnë pavarësi simbolike dhe shndërrohen në bartëse emocionale të përjetimesh. Në vargjet:

“këmbët që të trembura struken
nën atë ombrellë”

Ku këmbët personifikojnë dhe simbolizojnë frikën përballë së panjohurës, por edhe nevojën për mbrojtje, afërsi dhe intimitet.

Poezia e Andi Meçajt përfaqëson një zë të veçantë të letërsisë bashkëkohore.

Në të ndërthuren ndjeshmëria lirike, reflektimi filozofik dhe kërkimi estetik. Krijimtaria e tij trajton tema universale si koha, kujtesa, identiteti, dashuria si dhe raporti i individit me veten dhe botën moderne.

Gjuha poetike është e pasur në nëntekste, duke i dhënë secilës fjalë peshë kuptimore dhe emocionale. Lexuesi krijon ndjesinë se poeti po i rrefën një histori personale, një kujtim apo një ngjarje që ka mbetur e gjallë në ndërgjegjen e tij. Kjo afërsi komunikimi e bën poezinë e Meçajt të ngrohtë dhe njerëzore.

Një nga elementet më të dallueshme të këtij vëllimi është dashuria për njeriun. Asgjë nuk paraqitet si boshllëk dhe një prani e vazhdueshme shoqëron poezitë. Veçse një heshtje reflektuese dhe meditative, shndërrohet në një bashkudhëtare e mirë dhe e dashur e autorit dhe lexuesit.

Nëse kërkojmë dritën dhe gëzimin në poezitë e tij, i gjejmë kryesisht në këto tri elemente: Gonxhja që guxon të hapet, të qeshë dhe të përsëndesë diellin.

“Epsi” i bukur i natyrës: Ka një gëzim pothuajse fizik në përshkrimin e petaleve të brishta dhe aromës dehëse, që tregon se jeta gjithmonë gjen forcë të ripërtëritet dhe të festojë ekzistencën e saj pas çdo dimri.

Katarsisi dhe çlirimi gjenden te “Kjo dritë më transformon” ku gëzimi shfaqet në formën më të ëmbël shpirtërore: në formën e paqes dhe ekstazës mistike. Disa poezi janë një himn i vërtetë për vitalitetin dhe energjinë pozitive, aftësia për t’u shndërruar në dritë në fund të çdo udhëtimi të vështirë.

Andi arrin të ndërtojë një ekuilibër mes universales dhe individuale, mes përvojës personale dhe asaj kolektive.

Poezia e Andi Meçajt nuk synon të japë përgjigje përfundimtare, por të nxisë reflektimin. Përmes një gjuhe origjinale, figuracionit të pasur dhe një ndjeshmërie të veçantë artistike Andi ka krijuar një identitet të dallueshëm poetik, duke u renditur ndër zërat më interesantë të poezisë moderne shqipe.

ANDI MEÇAJ – MJESHTRI QË HOLLËSITË JETËSORE I QËNDIS ME ART POETIK

ALBERT HABAZAJ
BOTUAR NË GAZETËN
DESTINACIONI, 13.06.2026

Andi Meçaj është një poet, që me plot gojën e them, është në ballë të poezisë qytetare bashkëkohore, që prodhohet në Vlorë. Për Andin kanë shkruar emra të lartë të kritikës dhe studimit të letërsisë shqipe, si, fatmirësisht mësuesi im i shkollës së mesme në Tiranë, Sulejman Mato, poet i mirënjohur shqiptar, prof.dr. Roland Zisi – Rembrandt i letrave shqipe, prof. dr. Ardian Kycyku, dr. Alisa Velaj etj. Me kaq do të thosha që, në kuptimin më të mirë të fjalës, unë kam një zili dashamirëse që këta emra të lartë kanë shkruar për Andin, sepse ata kanë shkruar edhe për mua, edhe për Eqeremin, edhe për Anilën, edhe për Zanën, edhe për Elmën, edhe për Lauretën, edhe për Vjollcën, edhe për Zamirën, edhe për Luljetën, edhe për Dhorin, edhe për Hiqmetin, edhe për Ruzhdiun, edhe për Lelën, për të gjithë poetët e Vlorës kanë shkruar.

Unë do të ndalem në një pjesë të vockël të poezisë së Andit: Andi Meçaj – mjeshtri që hollësitë jetësore i qëndis me art poetik.

Andi Meçajn, poetin e talentuar, të veçantë dhe identitar, kam të drejtën dhe bindjen ta quaj edhe poet të imtësive, të hollësive jetësore, të atyre vogëlsirave të mezidukshme, apo që nuk vërehen nga një sy i rëndomtë qytetar. E veçanta e Andit është se ato imtësi i merr me kujdes dhe, në laboratorin e tij krijues, i gdhend, i qëndis dhe na i dhuron ne, si piktura poetike. Në fakt, qëndistarinë shkrimore të Andit e kemi shijuar artistikisht dhe estetikisht qysh para një çerek shekulli, me “Puthjen ujore”, që është edhe botimi i parë poetik i autorit, qysh para një ëerek shekulli. Të 6 vëllimet e tij poetike (“Puthje ujore” (Tiranë, Albin, 2001), “Tokë e bekuar” (Athinë, Toja, 2002), “Nga letërkëmbimi me një fantazmë” (Athinë, Toja, 2003), “Qyteti fle në xhepin tim” (Athinë, Enalen, 2006) “Një stacion si një valixhe: poezi të zgjedhura” (Vlorë, Triptik, 2009) dhe “Çelësat...” e Andit që botoi pas 17 vjetësh, janë të bukura, të dashura për lexuesin, se të ngjit në shpirt poezia e tij, me majë poetike, me ajkë kulture, me tharm qytetar; sidomos vëllimi poetik “Çelësat e viteve rrodhën”, 2026, është, për mua, filigran poetik.

Andi është edhe një tregimtar me zë të veçantë, është dhe piktor me penel të hollë, siç e shikojmë me pikurat e varura në kornizat që mbushin këtë galeri arti, e cila është e tëra e Andit sot, por unë do të qëndroj pak tek “Çelësat...” e Andit.

Andi Meçaj, ka aftësinë që ndjesitë vetiake t’ia përcjellë lexuesit nëpërmjet poezive aq të bukura e tërheqëse, saqë ne, që i lexojmë na duket se i njohim ata persona për të cilët flet autori, kalojmë në ato rrugica për të cilat ai thur vargje



aq origjinale...

Më duket se ai ka një magnet shpirtëror, ka një mister tërheqës që na vetvetiu na rrëmben e na fut këndshëm në lojën e tij, nën shiun e tij me bukuri të pabesueshme, në atë ditë të bukur vere, të ndjejmë shpërthimin e gonxhes, një peizazh detar, një ninullë te rrugakryqi, te pëshpëritjet e gjyshes, tek gënjeshtrat njerëzore, tek të vërtetat hyjnore, për shtëpinë e madhe dhe kujtesën e mureve, për karrigen e vjetër, ëndrrat e një vajze, pas perdeve, për klubin e Topanasë, për plakat e lagjes që bisedojnë, për lozhrambledhësit e qytetit ...(dhe këtu pas kësaj fjale të vogël do të ndaloj pakëz, se kam një vjershë, që më dhemb në shpirt, jo vetëm një një revoltë poetike, por me vargje therës dhe realë, janë ulërimë e shpirtit social e human për ata vertikalë që kanë vesh e paksa ndërgegje). Në vijim, magneti poetik i Andit na bën tanët gjithë ata emra të përveçëm, “personazhe poetike”, që në fakt ne s’ i njohim, por fisnikëria bujare e vargut të mençur të Andit na i bën të njohur e të dashur, për vitet që rrodhën deri thonjtë me manikyr, në imtësi pra, na bën pjesë integrale të mikrobotën e tij magjike.

Më ka bërë përshtypje të veçantë poezia “Lamtumirë fëmijëri” dhe të tilla simotra poetike me motivet e fëmijërisë të poetit Andi Meçaj, që mendoj se sot është një status poetik në qytetin tonë. Sa poezi të ndjera që janë! Motivët poetike të kujtimeve të fëmijërisë, të asaj shtëpisë jo thjesht si simbol i djepit të lindjes, oxhakut të

**Andi Meçaj,
poetin e talentuar,
të veçantë
dhe identitar,
kam të drejtën
dhe bindjen ta
quaj edhe poet
të imtësive,
të hollësive
jetësore, të atyre
vogëlsirave të
mezidukshme,
apo që nuk
vërehen nga një
sy i rëndomtë
qytetar. E veçanta
e Andit është se
ato imtësi i merr
me kujdes dhe, në
laboratorin e tij
krijues, i gdhend,
i qëndis dhe na
i dhuron ne, si
piktura poetike.**

ndezur, edukimit njerëzor, por gjithçka i takon asaj mikrobote aq të dëlirë, të mbushin me emocione, dashuri e trishtim.

Një nga poezitë më të arrira jo vetëm të Andit, por të gjithë poetëve që kanë motive të muzës së tyre, familjen, sidomos nënën e xhanit, është ajo me titull: “Mungesë” – Qeshja jote/ u mungon mureve,/ përkëdheljet e huaja/ s’ më shijojnë më,/ zëri i diellit/ s’ u këndon / më veshëve.

E di, vjen/ kur kam mërzë,/ mungesë ajri.
/ Kur ti vjen/ edhe heshtja gëzohet,/ trokëllinjë dritaret,/ gjallërohen pikturat/ fëshfërijnë lulet./
Sa çaste të ikura/ u rikthehen syve,/ ç’ ngjyra!

Vjen, ikën,/ bëhesh mjegull,/ ngelet,/ ngashërimi i mureve.”

Jam i mbushur, jam i mbushur me emocione të thella pikëlluese e nuk mund të bëj koment, veç të hesht me nderimtarin hyjnor për perëndeshën e Andit, këtij biri dinjitoz dhe poeti të vërtetë të ndjenjës. I dritëroftë shpirti Noçes së tij dhe të gjitha nënave që prehen tek yjet, në krahët e Paharrimit të bijve dhe bijave të tyre!

Edhe pse poet i imtësive, Andi Meçaj nuk mund të jetë kurrë një këngëtar akuariumi. Nuk ka se si të mos jetë ai një poet i angazhimit qytetar, i shqetësimit intelektual, “Gjyshi qytet” është një poezi klithmë. Edhe pse, e fyejmë, e tallim, e shpërfillim, e shpërdorim, e zhvasim,

VLORA DHE POETI

PSE POETI I VLORËS HIQMET MEÇAJ HESHT BURRËRISHT DHEMBSHUR?!

(Nga: Albert Habazaj)

*Shkruesit e vargjeve shtohen pa rritur si shkurret.
Poetët e paktë, si bredha të bukur, të lartë,
lukunia e shkurreve qelqit digjital turret.
S'ka më doganë të merret me shkrimin e artë.*

Poeti ynë hesht burrërisht dhembshur

*për qytetin eshtragërryer në furtunë,
për shtetin tonë lridashës çapaçul i shkukur,
për djalin e tij me universitet, poet e pa punë.*

*E... shpirti i tij pashfaqshëm çarë më dysh,
brenge mban sa mban barku i këtij dheu,
ka të drejtë me pashë të na thotë: “Hiqmoni sysh!”
Tek qartësonte imazhin tonë mjerisht të zbehur.*

*Ç’qytetarë të përndritëruar jemi të qytetit?,
mirë firmë e vulë, por nuk kemi as zë fare,
detachment me frymë drite për vendin e poetit
po s’u bëmë, na hëngrën krokodilët me kollare.*

*Mua më vjen turp të takoj Hiqmetin në Vlorë,
dhe malin, dhe lumin sikur mbaj mbi supe,
djali i tij pastron qytetin nga mbeturinat, kur ca të gJORË,
të paturpët hanë bukën e ditës me turpe...*

Ishte kënaqësi dhe plotësim shpirtëror për shoqërinë letraro-artistike të qytetit tonë veprimtaria e sotme në Galerinë e Arteve, Vlorë kushtuar mikut tonë Andi Meçaj, poet i ndjenjave të holla, prozator i mikrobotës së pasur dhe piktor i ngjyrave me dritë të bukur.

Faleminderit Qendra Kulturore Vlorë!

i thyejmë brinjët, gjyshi qytet s’mërzitet aspak, por “ai ngjit sërish brinjë të reja”. Ngjit brinjë të reja...

Para se të vijoj me fjalëzën për metaforikën e poezisë filozofike, ekzistenciale dhe intelektuale të Andit, “plotësuar me detaje dhe elemente

nga fantazia e tij e pasur, nisur gjithmonë nga një pikë reale, e thjeshtë dhe natyrale”, siç e cilëson prof. Zisi, do të them një histori. Në një fshat të Labërisë, komshi me fshatin tim dhe të babait të Andit, midis, ishin disa plaka ulur në sofa, që pinin kafe si zakonisht dhe bisedonin me njëra-tjetrën. Më tej ishin disa vogëlushë

që loznin. Një fëmijë çamarok qëllon me gurë një nënë atje, të vjetër. “Ooo” – ia bëri nëna, se i dhëmbi në kockë. I kthehet një plakë tjetër djalit: “vrave nënën, a të qëlloftë pika!”. “Mo ma shaj – i kthehet ajo me gjak në kërci, – se kam të Hasanit”. Hasani ishte i biri i nënës që mori gurin në kërci. Pra, edhe gjyshi qytet është yni dhe nuk na shan, se na ka të “Hasanit”, na ka djemtë e tij.

Rikthehem tek fjalëza për të bukurën poezi të Andit tek “Çelësat e viteve që rrodhën”. Këtu kemi një harmoni të shëndetshme të realitetit të përditësuar dhe të ngritur në art, me një bukuri të llahtarshme artistike, me një thjeshtësi të kulluar të shkrimtarisë poetike, prurë me individualitetin krijues të vargut modern. Një poezi, ku gjuha poetike na sjell imazhe të fuqishme për ta zburuar botën e brendshme, për të ndikuar në bukurinë e mënyrës së jetesës. Andit i dhemb lëndimi dhe pena është ilaçi për shërim, për shëndet, përmirësim dhe përparim.

Poezia e tij është e mirë dhe pëlqehet, se vjen me nivel artistik dhe shije estetike. Figurat stilistike nuk i ka qëllim më vetvete, por ato bulëzojnë natyrshëm dhe zënë vendin e tyre në organigramën poetike të autorit.

Andi Meçaj dallon për gjetjet poetike, për figuracionin e befte e aq të pasur, pa kërcitur, spikat Andi si poet i detajeve, prurë me vargje lakonike, që janë aq të bukura.

Vëmendje vlen të ketë miku ynë i çmuar i penës tek ndonjë rëmdomësi që shket e futet si pa kuptuar në vargjet e tij të shëndetshme petikisht, të bukura estetikisht, me me sazhe të larta kurajoje dhe dinjiteti.

Është fat për njeriun gjenetika, aq më tepër për poetin, por Andi nuk e ka shpërdoruar këtë gjë. Ai është vërtet i biri i Hiqmet Meçajt, poetit të madh të Vlorës dhe njërit ndër më të mirët në Shqipëri, por Andi ka qenë dhe është emri i tij i përveçëm, firma e tij poetike, pa pasur nevojë për tutor, as ombrellë, veç për vëmendje, ngrohtësi e dashuri.

Kryepoezia e gjithëhershme është imazhi fotografik me Poetin e Identitetit të Vlorës, Hiqmet Meçaj! Tani, do të më falni, se do të dal jashtë protokollit, por jo jashtë shpirtit dhe ndjesisë sime:



NGA NGJYRA TE FJALA: POETIKA E KUJTESËS URBANE NË VLORË TE ANDI MEÇAJ

NGA: LAURETA PETOSHATI

Në artin bashkëkohor vlonjat, qyteti nuk është më thjesht një hapësirë gjeografike, por një subjekt estetik i shumëfishitë, që rishfaqet përmes gjuhëve të ndryshme artistike. Piktori Roland Runaj dhe fotografi Julian Bleta, përmes ekspozitave të tyre mbi lagjet e Vlorës, e kanë rindërtuar qytetin si një strukturë vizuale ku drita, ngjyra dhe perspektiva funksionojnë si mjete të kujtesës. Në këto punë, lagjet nuk janë vetëm hapësira banimi, por shtresa të perceptimit vizual të jetës urbane, ku koha ngurtësohet në imazh dhe përvoja shndërrohet në shikim.

Në këtë horizont estetik, poezia e Andi Meçajt në vëllimin: “Çelësat e viteve që rrodhën”, mund të lexohet si një përkthim gjuhësor i të njëjtit qytet, ku Vlora nuk përjetohet përmes vizualitetit, por përmes kujtesës, emrit dhe narrativës së përditshme. Nëse artistët pamorë e shohin qytetin, poeti e rikthen në kujtesë. Në këtë kuptim, qyteti nuk shfaqet si sfond neutral, por si një hapësirë antropologjike e ngarkuar me histori njerëzore, ku çdo lagje, rrugicë apo ndërtesë funksionon si mbartëse e përvojës së jetuar. Topanaja, Lagjja e Re, shkallët e pallateve apo pijetoret e vogla urbane nuk janë thjesht toponime, por lieux de mémoire, (vendet e kujtesës), në kuptimin e Pierre Nora-s, ku kujtesa individuale dhe kolektive mbivendosen në të tashmen.

Një nga tiparet më të forta të këtij vëllimi është përdorimi i dendur i emrave të përveçëm dhe figurave të identifikuar përmes detajeve minimale. Në poezi si: “Shumëkatëshi”, “Ditë të përkëdhelura”, “Venecia e profesor Isufit”, “Në klubin e Topanasë”, “Lamtumirë fëmijëri”, “Pushime në atdhe”, “Katerina mban veshur katërmbëdhjetë vjetët”, “Plakat bisedojnë”, etj., emra si Eleni, Tiku, Mario, Katerina, Teuta, Agroni, Mira, Lola e të tjerë, nuk funksionojnë si karaktere të zhvilluara narrativisht, por si shenja indeksikale të ekzistencës sociale, që ruajnë gjurmën e individit në hapësirën poetike. Këta emra krijojnë atë që mund të përkufizohet si një onomastikë poetike e kujtesës urbane, ku emri nuk është etiketa e personazhit, por gjurma e një jete të jetuar.

Kjo prirje bëhet e dukshme në poezinë: “Shumëkatëshi”, ku çdo kat i ndërtesës shndërrohet në një mikro-univers identitar. Teuta me macet llafazane, Agroni që këndon arie në mesnatë, Mira që ëndërron të bëhet mjeke dhe Lola që eksploro-



ron përmes përvojës së saj feminitetin, nuk janë figura të ndërtuara psikologjikisht, por fragmente ekzistence të kondensuara në një detaj të vetëm domethënës. Në këtë mënyrë, ndërtesa nuk është strukturë arkitektonike, por një organizëm social i fragmentuar.

Në këtë sistem, edhe kur mungon emri si të poezitë: “Riciklim”, “Jashtë (tokësori)”, kemi një



identitet të përgjithësuar, ndërsa te poezia: “Luga”, identiteti ndërtohet përmes marrëdhënies afektive nënë-fëmijë, ku objekti i përditshëm shndërrohet në qendër të kuptimit poetik. Poezia funksionon si një mikronarrativë eliptike, ku “luga” vepron si objekt tranzicional dhe transformon aktin e ushqyerjes në hapësirë imagjinare loje dhe mbrojtjeje. Në fund, ndryshimi i trupit amësoz shënjon një metaforë të entropisë kohore, ku koha materializohet si transformim i heshtur i trupit dhe kujtesës. Në poezi si: “Te pijetorja, Gjashtë gllënja të shpejta”, individualizimi ndodh përmes situatës dhe jo përmes emrit. Figura e të dehurit që pyet: “Përse këndojnë natën varrezat?!” dhe narratori që refuzon përgjigjen krijojnë një strukturë dialogu ku kuptimi mbetet i hapur. Ky refuzim nuk është mungesë interpretimi, por një zgjedhje estetike që prodhon atë që mund të quhet pezullim hermeneutik i kuptimit, ku pyetja bëhet më e rëndësishme se përgjigjja.

Në këtë pikë, poetika e Meçajt afrohet me ndjeshmërinë e poetes Alda Merini, sidomos në mënyrën se si e zakonshme hapet drejt një dimensionit të padukshëm. Vargje si: “varrezat dinë të këndojnë, të këndojnë pa zë” nuk shpjegojnë realitetin, por e transformojnë atë në perceptim të dyfishtë poetik, ku heshtja dhe kënga bashkëjetojnë si shtresa të një të vërtete të papërkthuar. Megjithatë, ndryshe nga Merini, e cila operon me intensitet subjektiv dhe vizion të brendshëm shpërthyes, Meçaj ruan një ton më narrativ dhe të përmbajtur, duke u pozicionuar në një formë të

realizmit lirik të kontrolluar.

Në një plan më të gjerë krahasues, poetika e Meçajt mund të vendoset në dialog me poetin bashkëkohor italian Franco Arminio, i cili ndërton një poezi të komunitetit dhe të vendeve të vogla të Italisë së brendshme. Të dy autorët ndajnë një vëmendje të veçantë ndaj jetës së zakonshme dhe figurave të saj të vogla, por ndërsa Arminio fokusohet te fshati dhe braktisja, Meçaj ndërton një arkiv urban të qytetit shqiptar bashkëkohor, ku Vlora shfaqet si një hapësirë e gjallë dhe e zhurmshme kujtese.

Në dialog me artet pamore vlonjate, poezia e Meçajt krijon një sistem të përbashkët përfaqësues të qytetit. Nëse piktoret vlonjate e ndërtojnë Vlorën përmes dritës, ngjyrës dhe kompozimit vizual, poezia e Meçajt e ndërton përmes kujtesës, emrit dhe fragmentit narrativ. Kështu krijohet një marrëdhënie ndërsemiotike ku piktura dokumenton vizualisht, ndërsa poezia ruan emocionalisht.

Në përfundim, vëllimi “Çelësat e viteve që rrodhën” mund të lexohet si një arkiv poetik i jetës urbane vlonjate, ku qyteti nuk përshkruhet, por kujtohet, ku njerëzit nuk portretizohen, por ruhen si gjurmë dhe gjuha nuk zbkuron realitetin, por e mban atë të gjallë. Në këtë kuptim, Andi Meçaj pozicionohet si një poet i ndërmjetëm midis dokumentarit dhe lirikës, midis realitetit dhe kujtesës, duke ndërtuar një poetikë që e vendos Vlorën në qendër jo si imazh, por si kujtesë e gjallë e përvojës njerëzore.

(Vlorë më: 11 qershor, 2026)

VLERËSIME NGA AZEM TROQJE

Suzana Zisi na mblodhi sot për poezinë e Andi Meçajt, aty në sallën e bukur të Galerisë së Arteve, nën përkujdesjen e Anxhela Kapllanajt dhe Era Xhebros, u mblodhën disa nga miqtë e Andit dhe folën e recituan poezitë e djalit të padukshëm të rrugëve të qytetit tonë, atij djali fjalëpak që dikur shiste gurë të zbkuruar trotuareve për të nxjerrë bukën e gojës dhe ilaçet e babait të sëmurë, pakkush e dinte që ai djali i zakonshëm në botën e vogël, kishte një botë të madhe brenda vetes, aq të madhe, sa mund të gjeje aty krejt Vlorën e sotme, krejt Athinën e djeshme, me detin e me hënën, me rrugët, pijetoret, lulishtarët, me portat, dyert dhe çelësat e viteve që rrodhën...

Dikur, ne miqtë e poezisë, kur lexuam së pari poezitë e Andit, frikoheshim mos do ishte një kopje e vogël e babait të tij, të shquarit Hiqmet Meçaj, por ditë pas dite, poezi pas poezie, Andi na bindi, se ishte një zë krejtësisht i veçantë, kishte unën e tij poetik, i pangjashëm me askënd tjetër, nga ata që lënë gjurmë të thella në hullitë e kohës.

Para disa vitesh, 2011, ndofta, në një aktivitet letrar në qytetin e Fierit, rastësisht u ndodha pranë me poetin Maku Pone, atë kohë drejtor i tv Apolonia, kur i thashë se jam nga Vlora, u çel i tëri dhe më pyeti për Hiqmetin dhe Andin, ata emra ishin respekti i tij për Vlorën dhe vlonjatët, dhe krejt i sinqertë shtoi: “kujtoja se dija të shkruaja, hoqa dorë së shkruari kur lexova poezitë e Andi Meçajt”.

Falenderim Andi, jo vetëm për sot, për të gjithë vitet e poezisë, suksese më tej, miku im.

(Vlorë më: 11 qershor, 2026)



STILI POETIK I ANDI MEÇAJT: NDËRTHURJA E REALITETIT ME METAFORËN MODERNE DHE IMAGJINATËN LIRIKE

NGA: VJOLLCA ALIAJ

Promovim i librit poetik “Çelësat e viteve që rrodhën”

Poetika e Andi Meçaj zë një vend të veçantë në letërsinë shqipe të pas viteve '90. Poezia e tij karakterizohet nga një kombinim i natyrshëm i realitetit të përditshëm me elemente fantastike, metafora të papritura dhe një imagjinatë e lirë që e çon lexuesin përtej kufijve të zakonshëm të perceptimit. Në vargjet e Meçajt, bota reale nuk paraqitet thjesht si një pasqyrë e jetës së përditshme, por transformohet vazhdimisht në një univers poetik ku sendet, njerëzit dhe ngjarjet fitojnë kuptime të reja simbolike.

Realiteti si pikënisje e poezisë

Një nga veçoritë kryesore të stilit të Meçajt është se ai nisat pothuajse gjithmonë nga një situatë konkrete dhe e njohur. Një rrugë, një stacion autobusi, një filxhan çaji, një shtëpi, një plak që ecën me bastun apo një bisedë e zakonshme bëhen qendra të poezisë së tij. Mirëpo këto elemente nuk mbeten të zakonshme; ato shndërrohen gradualisht në simbole poetike. Në poezinë e tij, stacioni nuk është vetëm një vend pritjeje, por metaforë e jetës dhe e mungesës; shtëpia nuk është vetëm një ndërtesë, por kujtesë, mall dhe identitet; filxhani i çajit bëhet një hapësirë ku zhvillohen drama njerëzore dhe emocionale.

Kjo e bën poezinë e tij të afërt me lexuesin, sepse ai nuk flet për abstraksione të largëta, por për gjëra që njeriu i sheh dhe i prek çdo ditë.

Metafora moderne dhe surprizuese

Një tipar tjetër dallues është përdorimi i metaforës moderne. Ndryshe nga metaforat tradicionale që mbështeten kryesisht te natyra ose romantizmi klasik, Meçaj krijon lidhje të papritura ndërmjet objekteve dhe ideve.

Për shembull, ai mund të përshkruajë një të qeshur si një rufe, një shtëpi që ka ftohtë, një qiell që pikon qumësht, ose një sirenë policie si një varkë e shpuar që kërkon ndihmë. Këto figura nuk synojnë vetëm zbulimin e gjuhës, por krijimin e një këndvështrimi të ri mbi realitetin. Lexuesi detyrohet të ndalet dhe të mendojë mbi kuptimin e fshehur pas figurës poetike. Metafora e tij është shpesh vizuale, gjë që lidhet edhe me formimin e autorit si piktor. Pamjet poetike duken sikur janë piktura që lëvizin dhe marrin jetë.

Personifikimi dhe animizmi poetik

Në shumë poezi të Andit, objektet dhe fenomenet natyrore sillen si qenie njerëzore. Shtëpia dridhet nga të ftohtit, nata vetëvritet, dera zemërohet, shiu qan, era hyn në shtëpi si mysafire. Ky personifikim i vazhdueshëm krijon një botë ku kufiri mes njeriut dhe sendit zhduket.

Përmes kësaj teknike, poeti arrin të shprehë gjendje emocionale komplekse pa i përmendur drejtpërdrejt. Vetmia, nostalgjia, humbja ose gëzimi nuk shpjegohen; ato mishërohen në objekte dhe situata konkrete.

Fantazia dhe surrealizmi

Një dimension shumë i rëndësishëm i poezisë së tij është prania e elementeve surrealistike. Në botën poetike të Meçajt mund të shfaqen arinj që flasin, qilima fluturues, shtëpi që shkulen me rrënjë, hëna që lyen muret me spray, apo qenie të zakonshme që kalojnë papritur në një plan fantastik.

Megjithatë, ky surrealizëm nuk është i shkëputur nga jeta reale. Përkundrazi, ai shërben për ta zbuluar më mirë realitetin. Fantazia bëhet një



mënyrë për të folur për lirinë, pushtetin, dashurinë, kujtesën apo absurditetin e jetës moderne.

Ekzistencializmi dhe përvoja e mërgimit

Në shumë poezi ndihet një frymë ekzistencial. Temat e kohës, vetmisë, ikjes, kthimit, kujtesës dhe kërkimit të identitetit janë të pranishme vazhdimisht. Kritika letrare ka vënë në dukje se përjetimet e mërgimit dhe përballja me jetën larg atdheut kanë lënë gjurmë të dukshme në krijimtarinë e tij.

Kthimi, largimi, stacionet, valixhet dhe udhëtimet shfaqen shpesh si simbole të gjendjes njerëzore. Njeriu i poezisë së Meçajt është vazhdimisht në lëvizje, në kërkim të një vendi ku mund të ndihet i plotë.

Gjuha e thjeshtë dhe thellësia kuptimore

Një nga arritjet më të spikatura të autorit është aftësia për të përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, pa humbur kompleksitetin artistik. Fjalori i tij nuk është i rënduar nga retorika apo zbulimet e tepërta. Përkundrazi, ai ndërton poezi me fjalë të zakonshme, por i vendos ato në marrëdhënie të pazakonta, duke krijuar efekte të fuqishme estetike.

Kjo e bën poezinë e tij njëkohësisht të qasshme dhe sfiduese: lexuesi mund ta kuptojë sipërfaqen e tekstit, por sa më shumë e lexon, aq më shumë zbulon shtresa të reja kuptimore.

Humanizmi dhe vëmendja ndaj njeriut të zakonshëm

Në qendër të poezisë së Meçajt qëndron njeriu

i zakonshëm: i moshuari, endacaku, fëmija, emigranti, i dashuruari, i vetmuari. Ai nuk idealizon figura heroike, por fokusohet te përditshmëria dhe te drama e heshtur njerëzore. Edhe kur përdor humor, ironi apo elemente groteske, qëllimi mbetet zbulimi i së vërtetës njerëzore.

Për poezinë: “Lamtumirë fëmijëri”, shkëputur nga libri: “Çelësat e viteve që rrodhën”

Kjo poezi e Andit trajton humbjen e pafajësisë dhe kalimin nga fëmijëria në një realitet të ashpër shoqëror. Përmes figurës së Marios, poeti paraqet lojërat dhe sjelljet e papërgjegjshme të fëmijërisë, të cilat në fillim duken si shaka, por më vonë shndërrohen në veprime me pasoja serioze.

Ngjarja e emigrimit drejt Italisë shënon fundin e fëmijërisë dhe fillimin e një jete të re. Megjithatë, Mario nuk arrin të shkëputet nga sjelljet e së kaluarës dhe përfundon në burg për trafikim droge. Fundi i poezisë ka një ton ironik dhe të hidhur: shoku i tij më i ngushtë në burg është një maçok i zi, simbol që lidhet me të kaluarën e tij.

Tema kryesore e poezisë është humbja e pafajësisë, ndikimi i rrethanave shoqërore dhe pasojat që mund të kenë zgjedhjet e gabuara në jetë. Gjuha është e thjeshtë, rrëfyese dhe plot ironi.

LAMTUMIRË FËMIJËRI

Shokut tim të ngushtë, Marios,
i pëlqente të hidhte mace
nga kati i gjashtë,

t'u vinte flakën,
t'i lëshonte natën nëpër rrugica
si flakadanë shëtitës,
të mblidhte kaçole nëpër lokale,
t'i shtypte me gurë dhe t'ua fitonte
gjithë kaçolet e tjera në lojë
djemve të lagjes,
pastaj të hypte në tarracën e pallatit
dhe t'i vërviste që andej
me sa fuqi kishte,
ato binin si shi florinjsh nëpër rrugë,
të lagte njerëz me pistoletën me ujë,
të vriste me shpata si tre mosketjerët,
të rrihej me ndonjë që s'ia pëlqente fytyrën,
të tallte në rrugë atë që i dilte përpara.
Derisa dikush na lajmëroi
që po iknin me anije, varka,
rimorkiatorë e trape, drejt Italisë.
Atëherë u lamë lamtumirën
shakave, lojërave, ia mbathëm.
Por Marioja s'i harroi kurrë shakatë,
ndërsa kthehej nga qyteti ynë i lindjes
për në Bari, e kapën me disa kile bar të ndaluar
fshehur në astarin e palltos.
Tani, kur e marr ndonjëherë në telefon,
më thotë duke qeshur: “Shoku im i ngushtë,
këtu në burg, është një maçok i zi!”
Urime e suksese poetit Andi Meçaj!

(Vlorë më: 11 qershor, 2026)



INTERVISTË ME BAJRAM DHE ERION KARABOLLI

- INTERVISTOI SHEILA REXHO -

Njihuni me intervistën familjare (bab e bir) të përkthyesve kallaratas, Bajram e Erion Karabolli.

Në letërsi, shpesh më të rëndësishmet janë pikërisht pranitë, të cilat nuk e kërkojnë me çdo kusht qendrën e vëmendjes. Për herë të parë, Bajram dhe Erion Karabolli vijnë së bashku në një intervistë ekskluzive, duke sjellë jo vetëm historinë e një bashkëpunimi të vyer në përkthim, një trashëgimi shpirtërore të vecantë, por edhe portretin e një etike të rrallë kulturore. Të dy kanë kontribuar me përkushtim që letërsia hispanike të jetësohet në shqip, e pasuruar me te gjitha nuancat e diapazonit të tyre gjuhësor dhe kulturor prej viteve të jetuara në Argjentinë. Në këtë duo, përvoja dhe pesha e emrit të Bajram Karabollit plotësohen natyrshëm nga profili publik me i rezervuar i Erion Karabollit, larg prej te zakonshmes se vetëpromovimit në epokën digjitale. Kjo tërheqje elegante, kjo mënyrë për ta lënë veprën të flasë përpara vetes, i jep kësaj bisede një tjetër lloj hijeshie, pasi nuk ndalemi vetem mbi përkthimin, por edhe mbi një formë më të përlulur, më fisnike dhe më të thellë për t'i shërbyer letërsisë.

BAJRAM KARABOLLI



PYETJE: Si lindi raporti juaj me përkthimin? A u krijua përmes leximit, përmes përvojës jetësore në Argjentinë, apo si një mënyrë për t'i afruar botët me njëra-tjetrën?

PËRGJIGJE: Raporti im me përkthimin ka lindur herët, qysh kur isha nxënës në gjimnaz, ku mësonim dy gjuhë të huaja, rusisht dhe frëngjisht. Aty përktheja ndonjë poezi apo ndonjë mini-tregim nga këto dy gjuhë që viheshin te këndi letrar i shkollës. Atëherë, mora guximin dhe i dërgova një reviste letrare një tregim të shkurtër të një autoreje franceze dhe tejet i gëzuar prisja numrin e ardhshëm të asaj reviste. Por më erdhi një përgjigje ku më qortonin të mos përktheja autorë borgjezë që binin ndesh me mësimet e partisë dhe me formimin tonë marksist-leninist. Kjo më bëri të hiqja dorë nga përkthimet letrare.

Kaluan dekada. I kisha kaluar të pesëdhjetat dhe ndodhesha emigrant në Argjentinë. Rastësisht, lexova në një gazetë letrare tregimin “Thuaju të mos më vrasin” të shkrimtarit meksikan Juan Rulfo. Ky tregim më rrëmbeu aq shumë sa u betova: Nuk do të vdes, pa e përkthyer këtë shkrimtar në gjuhën shqipe. Kësisoj, rashë sërish në kurthin e përkthyesit.

PYETJE: Ju keni sjellë në shqip disa nga emrat më të rëndësishëm të letërsisë hispanike. A ka autorë që ju kanë kërkuar vetëm mjeshtrinë gjuhësore, dhe të tjerë që ju kanë kërkuar diçka më shumë: Ndoshta një lloj transformimi të brendshëm?

PËRGJIGJE: Një përkthyesi i nevojiten patjetër dy veti. Së pari: të dijë mirë dy gjuhët, atë të autorit dhe atë në të cilën do të sjellë veprën letrare. Por e theksoj se më e rëndësishme është gjuha ku sjell veprën letrare. Së dyti: duhet, patjetër, të ketë talentin për krijime letrare. Nëse nuk i ka këto veti, nuk duhet t'i futet përkthimit letrar.

PYETJE: Si e keni menaxhuar ju ekuilibrin mes përlësisë dhe besnikërisë ndaj autorit dhe gjurmës tuaj, që pashmangshmërisht keni lënë si përkthyes në një vepër letrare?

PËRGJIGJE: Natyrisht, një lexuesi me kulturë, kur lexon një libër artistik të përkthyer, i lind pyetja se sa besnik duhet të jetë përkthyesi në përkthim. Por brenda kësaj pyetjeje ka pyetje të

tjera: Besnik ndaj kujt?: Ndaj origjinalit të tekstit, domethënë ndaj autorit, apo ndaj gjuhës ku e çon, domethënë ndaj lexuesit? Më përmbledhtas: Sa të vërtetë ka në thënien e famshme: “Traduttore, traditore”?

Sipas Franz Rosenzëig përkthimi është një zanat prej shërbëtori. Qysh këtu lind drama e përkthyesit. Por vuajtja e vërtetë e tij është se ai endet pa pushim midis besnikërisë dhe tradhtisë. Çfarë duhet të zgjedhë ai? Kujt t'i qëndrojnë besnik? Veprës origjinale apo gjuhës së tij? Pra, në vija të trasha, përkthyesi ka dy rrugë për të përkthyer.

E para: t'i qëndrojnë besnik origjinalit, domethënë gjuhës së autorit. Kësaj mënyre Schleiermacher i thoshte: “të përcjellësh lexuesin tek autori”. Në këtë rast, në njëfarë mënyre, përkthyesi tradhton gjuhën, në të cilën e çon veprën artistike, domethënë, lexuesin, bashkatdhetarin e tij. Për pasojë, mund të ketë vështirësuar kuptimin apo, më mirë, perceptimin dhe përjetimin e saktë të situatave dhe personazheve të veprës.

E dyta, e kundërta e së parës: nëse vepra shqipërohet, siç bënte i madhi Fan Noli, në këtë rast Schleiermacher thoshte: “të përcjellësh autorin tek lexuesi”, domethënë, përkthyesi ka arritur ta bëjë veprën tejet të kuptueshme për

lexuesin, por, në këtë rast, kultura e veprës origjinale do të ndjehet e “vjedhur” apo “e dëmtuar”, domethënë, përkthyesi ka tradhtuar origjinalin, autorin.

Siç shihet, ndërmjet përkthyesit dhe autorit, përherë ka njëfarë marrëdhënie të ndërlikuar dhe, kësajsoj, thënia “Traduttore, traditore” përherë qëndron.

PYETJE: Përkthimi i letërsisë hispanike, a ju bën të mendoni, se jo vetëm po sillni në shqip vepra të mëdha, por se njëkohësisht po formësoni, në njëfarë mënyre, edhe vetë shijen letrare të lexuesit shqiptar?

PËRGJIGJE: Pyetja juaj është e rëndësishme dhe e domosdoshme për një përkthyes. Rinia ime i përket asaj kohe të mbrapshtë, kur, si plot gjëra të bukura, edhe letërsia bashkëkohore perëndimore konsiderohej e rrezikshme dhe që rreptësisht e ndaluar. Kësisoj, atëherë njohja ime e letërsisë hispanike ishte: «Don Kishoti», disa poezi nga Pablo Neruda, nga Garsia Lorka, nga Nikolas Gijen, një roman i Migel Asturias, një i Markesit, një apo dy të Isabela Ajendes dhe ndonjë gjë tjetër e vogël.

Dhe nuk ka më shumë se një çerek shekulli kur rashë në kontakt me letërsinë hispanike, ose më saktë me letërsinë latino-amerikane, sidomos me rrymën e Realizmit Magjik, e cila më rrëmbeu dhe më bëri rob të saj.

Autorë madhështorë si Borhes, Kortasar, Rulfo, Arlt, Fuentes, Gabriela, Mistral, Ruben Dario, Antonio Maçado, Oktavio Pas, Haime Sabines, Nikanor Parra, Alejandra Pisarnik, Mario Benedeti, Alfonsina Storni, Kiroga, Rosi, Galeano e sa e sa të tjerë, i njoha dhe i lexova për herë të parë, kur shkova në Amerikën Latine. Të them të drejtën, më vinte turp nga vetja që nuk ua kisha dëgjuar as emrin këtyre gjigantëve të letërsisë botërore. Pra, në këtë moshë madhore u njoha me letërsinë hispanike. Atëherë mora vesh se letërsia hispanike qenkësh një oqean i tërë, ku u futa dhe lundrova nëpër të, i çmeritur e i lumturuar. Autori i parë i kësaj letërsie magjike ishte Huan Rulfo me dy veprat e tij: romani “Pedro Paramo” dhe vëllimi me tregime “Rrafshina në flakë”. Kur lexova këto vepra letrare u betova: Nuk vdes pa e përkthyer në shqip këtë autor. Kësisoj, kur po shkoja tek të gjashtëdhjetat, iu futa sërish rrugës së përkthimit.

PYETJE: Duke qenë se “Pedro Páramo” edhe për ju është një ndër romanet më të mirë të të gjitha kohërave, a e bëri kjo afërsi shpirtërore përkthimin më të natyrshëm, apo përkundrazi më të vështirë, sepse përballë një vepre të dashur njeriu ka edhe më shumë përgjegjësi?

PËRGJIGJE: Po. Ashtu e kam konsideruar veprën letrare të Rulfos. Siç thashë edhe më lart, Rulfo më futi përfundimisht në rrugën e përkthyesit. Por personazhet e Rulfos janë fshatarë nga shteti Halisko, një krahinë rurale në Meksikë ku flitet një spanjishte e veçantë. Plot fjalë të tyre nuk i gjen në fjalorin e spanjishtes. Duke kërkuar gjeta fjalorin e veçantë spanjisht të atij shteti meksikan. Veç kësaj vështirësie edhe stili i të rrëfyerit të Rulfos është i veçantë. Kështu që m'u desh shumë punë në përkthimin e këtij autori. Krahina e Haliskos dhe banorët e saj më ngjanin si krahina jonë e Labërisë dhe banorët e saj si labët, prej nga jam edhe vetë. Ky fakt më ndihmoi të kapërcej shumë pengesa leksikore që hasa gjatë përkthimit të veprës së Rulfos. Gjithsesi, ka raste kur përkthyesi has në ndonjë pengesë të pakapërcyeshme.



ERION KARABOLLI

PYETJE: Të jeni rritur prej një përkthyesi si Z. Bajram Karabolli do të thotë, ndoshta, të jeni ekspozuar më herët ndaj letërsisë. Kur e keni ndjerë, atë thirrjen e brendshme për t'iu dedikuar përkthimit?

PËRGJIGJE: Është e vërtetë që kontakti im me përkthimin ka ndodhur falë tim ati, duke redaktuar apo korrigjuar, le të themi, përkthime të tijat, fillimisht kur haste për shembull ndonjë shprehje apo fjalë të zhargonit popullor argjentinas. Dhe kësaj, gradualisht, ashtu si ndonjë rrymë e lehtë që rritet pa u vënë re, besoj se u rrit edhe dëshira ime për të përkthyer. Sinqerisht, nuk e di nëse ka një çast të shënuar, apo të veçantë, por nëse do ishte e domosdoshme ta shënoja një moment, një autor apo një vepër, atëherë do të thosha, leximi i poezive dhe romanit “Armëpushimi”, të Benedetit.

PYETJE: A ka pasur periudha në jetën tuaj kur jeni kthyer më shumë nga poezia se nga proza ose anasjelltas? Dhe çfarë mendoni se e ka përcaktuar këtë afërsi në kohë të ndryshme?

PËRGJIGJE: Mund të them se përkthimet e para, ose për të qenë i sinqertë dhe i saktë, përpjekjet e para të përkthimit, kanë qenë poezi, siç thashë më sipër, poezitë e Benedetit. Mandej, ndoshta është e vërtetë që mund të ketë ndonjë periudhë apo moment që më vjen më ndoresh poezia, dhe të tjera proza. Por është diçka që as e planifikoj eas e zgjedh, është diçka që thjesht vjen dhe e pranoj, mbase varet edhe nga gjendja shpirtërore, apo edhe faktorë të tjerë të brendshëm që ndikojnë.

PYETJE: Duke qenë se keni jetuar në Argentinë, sa ka mbetur prej asaj bote në mënyrën si e dëgjoni spanjishten? Dhe si kalon më pas kjo kujtesë e gjallë në shqip, kur për-

piqeni të ruani jo vetëm kuptimin, por edhe frymën e një teksti?

PËRGJIGJE: Unë përnjëmend e njoh dhe e konceptoj spanjishten prej “kastiliançes” së Argjentinës, ose prej “portenjës”, dialektit të Buenos Ajresit, ashtu siç e kam njohur dhe konceptuar shqipen prej toskërishtes, e më saktë prej “vlonjatçes”. Besoj se është e natyrshme, pasi kontakti im me spanjishten, qysh në adoleshencë, që “portenjoja”. Dua të them se ky është thelbi im gjuhësor e jo që kaq është krejt gjuha ime, pasi ndryshe do ta kisha të pamundur përkthimin. Megjithatë, ndiej se më qëndron pak i madh termi apo përkufizimi i përkthyesit të kryer e të mirëfilltë. Më shumë mendoj se jam në fillim të rrugës së përkthimit. Dhe siç thotë Maçadoja, rruga bëhet duke ecur. Shpresoj të kem këmbë për të ecur sa më gjatë.

Sa i përket pyetjes se si kalon në shqip, kuptoj se do të thuash si është procesi i përkthimit

brenda mendjes. Të them të drejtën, nuk besoj se kam ndonjë formulë të saktë e precize. Besoj se përkthimi më tepër se gjithçka tjetër është qasje.

PYETJE: Kur përktheni një tekst, çfarë përpiqeni të mbronni më shumë: (zërin e autorit, ritmin, strukturën e fjalisë, apo atë brendinë emocionale shpesh të pashkruar)?

PËRGJIGJE: Dyzimi i përvetshëm i përkthyesit. Pyetja jote Sheila, kur thua çfarë përpriqesh të mbrosh më shumë, e lë më se të qartë se është a pagjasë të ruhen në mënyrë të barabartë krejt elementët që po përmend. Ta bësh autorin sa më shqiptar, apo lexuesin sa më argjentinas, amerikano-latin, a spanjoll, në rastin tim, kjo është çështja. Është një proces paksa i gjatë, në përkthimin e parë të një teksti, të rishikuar, korrigjuar e redaktuar, i qëndroj sa më besnik autorit, më pas, në rishikimet e mëpasshme e deri në redaktimin, i afrohem lexuesit. Përpriqem të gjej një pikë të

Ndër autorët e mi më të preferuar mund të them se janë Borhesi e Kafka. Por edhe të tjerë që s'mund të mos i përmend, si Roberto Huarros, Benedeti, Kortasar, Antonio Porçia, Roberto Arlt, Alejandro Dolina, Kiroga e shumë të tjerë. Pa dyshim që, çka lexon, ndikon në shpirt, në mendim e në botëkuptim, ashtu sikurse, çka hamë, ndikon në trup.

Përkthimet e para, ose për të qenë i sinqertë dhe i saktë, përpjekjet e para të përkthimit, kanë qenë poezi, siç thashë më sipër, poezitë e Benedetit. Mandej, ndoshta është e vërtetë që mund të ketë ndonjë periudhë apo moment që më vjen më ndoresh poezia, dhe të tjera proza. Por është diçka që as e planifikoj eas e zgjedh, është diçka që thjesht vjen dhe e pranoj, mbase varet edhe nga gjendja shpirtërore, apo edhe faktorë të tjerë të brendshëm që ndikojnë.

mesme, të mesmen e artë, ndonëse qartësisht, e mesmja e artë është diçka utopike, besoj. Por mund të them, gjithashtu, se në fillimet e mia i qëndroja shumë besnik autorit. Por edhe tani, besoj se e mesmja ime ende anon nga autori.

PYETJE: Nëse mendoni për autorët tuaj të preferuar, a ka ndonjë prej tyre që ka ndikuar jo vetëm në shijen tuaj si lexues, por edhe në mënyrën si e kuptoni sot letërsinë, gjuhën dhe mjeshtrinë për t'i transmetuar emocion lexuesit?

PËRGJIGJE: Për të qenë i sinqertë me ty, nuk e shquaj veten për ndonjë lexues të zellshëm, më tepër lexoj kur përkthej. Natyrisht kam lexuar e lexoj diçka edhe kur nuk përktheja ose përkthej, por dua të them se lexoj përgjithësisht si përkthyes. Borhesi kur ishte profesor i Letërsisë Amerikano-veriore në Universitetin e Buenos Ajresit, u thoshte studentëve, “nëse Don Kishoti (apo çdo libër tjetër) të bëhet i mërziqshëm, zgjidhja është e thjeshtë: lëre, mos e lexo”. Mbështeste teorinë se leximi duhet të jetë një mënyrë kënaqësie dhe jo një detyrë e imponuar prej famës apo vjetërsisë së veprës. Dhe unë shpesh përfundoj së lexuari librat që më ngjallin kënaqësi, pa e ndier veten të detyruar që ta mbaroj së lexuari çdo libër që nis. Ndër autorët e mi më të preferuar mund të them se janë Borhesi e Kafka. Por edhe të tjerë që s'mund të mos i përmend, si Roberto Huarros, Benedeti, Kortasar, Antonio Porçia, Roberto Arlt, Alejandro Dolina, Kiroga e shumë të tjerë. Pa dyshim që, çka lexon, ndikon në shpirt, në mendim e në botëkuptim, ashtu sikurse, çka hamë, ndikon në trup. Mandej, se sa ka ndikuar çdo autor tek unë, përnjëmend nuk e kam bërë një analizë të mirëfilltë me veten. Por tani që po më, do më pëlqente të thosha se kryesisht kanë ndikuar autorët argjentinas.



FALENDERIM

Ky numër i gazetës "Kallarati" sponsohet nga Restorant Andoni – Vlorë, me administrator Andon Leskaj.

E falënderojmë nga zemra Andonin, i cili vazhdimisht ka qenë dhe mbetet mbështetës i Shoqatës "Kallarati" dhe i veprimtarive të saj.

I urojmë suksese të mëtejshme në biznesin e tij privat familjar, i cili ka krijuar një emër të mirë në Vlorë e më gjerë, duke nderuar jo vetëm veten dhe familjen e tij, por edhe Kallaratin.

Shprehja kallaratase "Takohemi te Andoni në Vlorë" tashmë nënkupton për këdo mishin e pjekur bio, gatimet tradicionale dhe, mbi të gjitha, mikpritjen e ngrohtë që Andoni dhe familja e tij dinë ta japin aq bukur.

Faleminderit, Andon Leskaj!

Faleminderit, Restorant Andoni – Vlorë!



KALLARATI ME HISTORI

- POEZI NGA XHELO TOZAJ -

Vargjet e mëposhtme nuk janë thjesht vargje, janë kujtime, mall, dhimbje dhe dashuri për Kallaratin. Janë fjalë që nuk maten me rregulla letrare, por me rrahjet e zemrës së një biri që nuk e ka harruar kurrë vendlindjen e tij. Në çdo varg ndjehet historia, sakrificat, rrënjët dhe shpresa se, Kallarati do të jetojë gjithmonë, pavarësisht kohëve, largësive apo vështirësive. Janë vargje që na prekin, na bashkojnë dhe na kujtojnë se fshati ynë është pjesë e identitetit tonë. Mirënjohje Xhelos për këtë dhuratë shpirtërore dhe për dashurinë e sinqertë që i ka falur Kallaratin. (Nga redaksia)

KALLARATI ME HISTORI

Kunjova i solli zi,
u vendos në Piligri,
ndërtoi fshat për bukuri,
gati me njëqind shtëpi.
Banjo brenda e havlli,
Bogonica si çati.
Greku na bëri kërdi,
e dogji, e bëri hi.
Luftuan me trimëri,
pesë burra u bënë fli.
Mbetën muret për stoli,
lapidari për karshi,
na tregon histori.
Fshati zbriti në vërri,
krijuan vatan e shtëpi,
mëhalla edhe vëllazëri.
Lumi lezet për bukuri,
vadit arat për mrekulli.
Me dy qendra lezeti:



Morrza e Ubavi.
Po filloi lufta prapë,
heronj e dëshmorë në fshat,
e lanë vendin me gjak.
Simbol lapidari i lartë.
Kur erdhi pushteti i ri,
u bë organizimi për mrekulli,

punoi fshati në bashkësi,
mori një zhvillim të ri.
Shkolla, kulturë e infermieri,
u përgatitën kuadro të rinj,
sipas kërkesave në ekonomi,
në arsim e shëndetësi,
që sot kanë lënë histori.

Por erdhi një jetë ere,
si gjithë bota, edhe ne,
me një metodë të re,
lamë tokat e shtëpinë,
edhe morëm arratinë:
Greqinë e Italinë.
Lamë mbropa pleqërinë,
i harruam ç'farë ndërnuar,
në gërmadha u transformuan,
qendrën e kanë shëmtuar.
Historia na ka kalit,
jemi popull që bëjmë dritë,
këtë e kemi treguar
me fshatrat që kemi rindërtuar,
kur halllet na kanë detyruar.
Edhe puna ka filluar,
me njerëz të kulturuar,
që nga Kina e larguar.
Bashkëfshatarët janë bashkuar,
për ndriçimin kanë ndihmuar,
vendin e kanë gjelbëruar.
Kostumet janë investuar,
qendra e zërit u siguruan
nga një pasardhëse e kulturuar,
të atin për ta nderuar,
që fëmijët kish mësuar.
Bashkëfshatarë të nderuar,
nga do që shkoni e keni ndaluar,
mos harroni fshatin tuaj.
Ju që keni vatane,
mos i lini të bien fare,
se prindërit tuaj kanë kaluar
shumë halle.
Nga: Xhelo Tozaj, Durrës, 11.01.2026

FALËNDERIM PËR SHKËLQIM LAÇAJ (LESKAJ)

Një falënderim në emër të Kryesisë së Shoqatës "Kallarati", por edhe të lexuesve të uebsajtit www.kallarati.com për z. Shkëlqim LAÇAJ (LESKAJ), i cili jo vetëm ka financuar hapjen e këtij uebsajti në vitin 2011, por realizon çdo vit (duke përfshirë edhe vitin 2025-2027) mirëmbajtjen e tij me një kuotë të caktuar financiare, duke bërë të mundur që bashkëfshatarët e tij kudoqofshin të gjejnë informacionin e nevojshëm për vendlindjen e tyre, KALLARATIN.

Kushdo mund të kontribuojë për vendlindjen, jo vetëm financiarisht e materialisht, por edhe me çdo lloj forme tjetër.

Ju mirëpresim!



VAJZA LABE – NGA ELENA MEMUSHAJ!

*Mes maleve ku era këndon histori,
rritet vajza Labe me dritë në sy,
me zemër që rreh veç për këtë tokë,
krahë hapur qiellit: jam krenare i thotë.
Në djep i kënduan këngë trimërie,
me ninulla e këngë atdhedashurie,
trashëgoi zakonet, besën e nderin,
si gur të çmuar ua ruan vlerën.
Kur vesh kostumin popullor krenare,
i duket vetja si shqiponjë mbi male,
në çdo qëndisje sheh gjurmët e brezave,
historinë e shkruar në duart e nënave.
E kuqja i flet për gjakun e derdhur,
e bardha për amanetin e patretur,
aty ka këngë, ka lot, dhimbje, kujtime...
Aty jeton zemra e Shqipërisë solime.
Foshnjën në krah kur e mban, me dashuri
i mëson që herët emrin "Shqipëri",
që të rritet krenar për atdheun e vet,
për gjuhën e bukur ku e ardhmja e thërret.
Vajzë labe, bukuri stolisur,
Cilësitë në fije ari qëndisur,
Si dritë e diellit, si dritë e hënës,
e për më shumë mëkuar në sisë të nënës.*



TAKIM PAS 52 VITESH

DJE NA BASHKOI SHKOLLA "MUMIN SELAMI", SOT NA BASHKON JETA

NGA BESNIK GJONBRATAJ

Në datën 20 qershor 2026 në Vlorë zhvilluam një takim të veçantë, të shumëpritur dhe plot emocion: takimin e ish-nxënësve të klasës së tetë të shkollës "Mumin Selami" të Kallararit, të cilët përfunduan shkollën në vitin 1974, plot 52 vite më parë, ose 60 vite nga dita kur nisën klasën e parë.

Takimi nisi fillimisht te kafe "Riviera", në Skelë, aty ku përshëndetjet e para, buzëqeshjet dhe përfaqimet hapën portën e kujtimeve. Më pas, vijoi një shëtitje e bukur buzë detit, në Lungomaren e Vlorës, ku deti, ajri i pastër dhe pamja e qytetit e bënë edhe më të ngrohtë këtë ditë. Pas kësaj, u ulëm së bashku për një drekë të shijshme buzë detit, te restoranti i kallaratasit "Vani", ku gatimet e detit dhe shërbimi i mirë i dhanë takimit edhe më shumë shije e kënaqësi.

Në këtë takim ishim së bashku me: Luan Jonuzaj, Alim Mehmetaj, Besnik Gjonbrataj, Shefo Jonuzaj, Dafina Davaci, Antoneta Muharremi, Fize Mejdiaj e të tjerë. Sigurisht, disa shokë e shoqe munguan për arsye largësie jashtë vendit, për probleme familjare apo shëndetësore, si: Fiqirete Qejvani, Luljeta Ribaj, Kado Mehmetaj, Mjaftime Goxhaj, Avdul Demiraj dhe Vitori Demiraj. Edhe pse nuk ishin fizikisht mes nesh, ata ishin të pranishëm në bisedat, kujtimet dhe urimet tona.

Një moment i këndshëm i ditës ishte edhe takimi i rastësishëm, por shumë i mirëpritur, me doktor Edmond Breshanaj, ish-nxënës i kësaj shkolle, një vit para nesh. Të pranishme ishin gjithashtu edhe Sulua bashkëshortja e Dafinës, si dhe Luiza, bashkëshortja e Besnikut, të cilat iu bashkuan natyrshëm kësaj atmosfere miqësore e të ngrohtë.

Ishte një takim shokësh e shoqesh, ku u bashkuan malli, dashuria, nostalgjia, përfaqimet dhe kujtimet e atyre viteve që nuk harrohen. Kujtuam



me shumë respekt mësuesit tanë, nga klasa e parë deri në të tetën, të cilët na dhanë jo vetëm dituri, por edhe edukatë, kulturë dhe dashuri për jetën. Për ta ruajmë mirënjohje të thellë. Kujtuam edhe veten tonë si fëmijë: ngacmimet e vogla fëminore, provimet, ditët në bankat e shkollës, shokët, shoqet, lojërat, frikërat e vogla dhe gëzimet e mëdha të asaj moshe.

Por, bashkë me këto kujtime, sollëm ndër mend edhe prindërit tanë, që me aq përkushtim na rritën, na edukuan dhe na arsimuan, shpesh mes vështirësive, por gjithmonë me dashuri e sakrificë.

Pas përfundimit të klasës së tetë, rrugët tona u ndanë. Disa vazhduan shkolla të tjera, disa nisën udhën e punës, më pas secili krijoi familjen e vet. Sot jemi prindër, gjyshër e gjyshe, me thinjat e viteve mbi krye, por me atë pjesë të fëmijërisë ende të gjallë në shpirt. Me disa prej shokëve e shoqeve kishim plot 52 vite pa u parë, e megjithatë, sapo u takuam, e njohëm njëri-tjetrin menjëherë. Koha kishte ndryshuar pamjen, por jo kujtimin, jo zërin e shpirtit, jo afërsinë e dikurshme.

Takime të tilla janë të nevojshme dhe të çmuara. Ato na kthejnë pas në kohën kur ishim të gjithë njëlloj, të sinqertë, pa djallëzi, me zemër të pastër dhe me shoqëri të vërtetë. Ato na kujtojnë se shkolla nuk është vetëm një ndërtesë ku mësohen shkronjat e numrat, por një vend ku lindin miqësi, kujtime dhe lidhje që i rezistojnë kohës.

Falënderojmë nga zemra çdo pjesëmarrës e pjesëmarrëse në këtë takim. Urojmë me gjithë shpirt që të jenë mirë edhe ata që nuk mundën të vinin dhe shpresojmë që në takimin e radhës të jemi edhe më shumë.

Një falënderim i veçantë shkon për Fize Mejdiaj, iniciatoren e këtij takimi, e cila me kujdesin dhe dashamirësinë e saj bëri të mundur që pas kaq shumë vitesh të mblidheshim sërish.

U takuam, u çmallëm, kujtuam, qeshëm, ndamë emocione dhe u ndamë me dëshirën për t'u takuar përsëri sa më shpejt.

Dje na bashkoi shkolla "Mumin Selami", sot na bashkon jeta.



ËSHTË KOHA TË RIORGANIZOJMË GRUPIN TONË "BOGONICA"

– Nga Besnik Gjonbrataj –

Të dashur bashkëfshatarë dhe miq të fejsbukut! Prej disa ditësh me radhë, ju ndoqët me kënaqësi këngët e kënduara nga grupi "Bogonica" i Kallararit, të regjistruara gati 30 vjet më parë, pikërisht në vitin 1995. Edhe pse kanë kaluar kaq vite, ato vijnë sot te dëgjuesi po aq të gjalla, të freskëta e autentike, ashtu siç është vetë kënga labe, me melodinë e saj të veçantë, me shpirtin e saj burimor dhe me dialektin e bukur të Kallararit.

Ky grup, me emrin simbolik "Bogonica", mbart një domethënie të veçantë. Ashtu si mali i Bogonicës simbolizon qëndrueshmëri, forcën dhe krenarinë e fshatit tonë, edhe këngët e këtij grupi simbolizojnë ruajtjen pastër e pa deformime, të këngës sonë polifonike labe në përgjithësi, e asaj kallaratase në veçanti.

Këto këngë, me një larmi të pasur tematike — historike, lirike, shoqërore dhe humoristike — i këndojnë me dashuri Kallararit dhe Labërisë në përgjithësi. Këngë si "Kallarati njëqind shtëpi", "Labëri moj sa të dua", "O bo bo djemtë mbi dete", "Hëna që del në Bogonicë", "Luan ç'luan hënëza", "Një Trimi", "Xhinde mushka xhinde vetë" e të tjera, janë krijime me tekst të rapsodit popullor Llambro Hysi dhe janë interpretuar aq bukur nga marrësit: Myzafer Laçaj dhe Evgjëni Jonuzaj, si edhe nga kthyesit: Zeqo Hoxhaj (ndarë nga jeta), Andon Begaj e Gjergji Leskaj, me iso të: Mihal Goxhaj, Agurim Jonuzaj, Kastriot Goxhaj, Ladi Kondaj (ndarë nga jeta), Kastriot Sadikaj e të tjerëve.

Këto këngë janë incizuar në RTSH në vitin 1995, nën udhëheqjen artistike të rapsodit popullor kallaratase Llambro Hysi dhe me mbështetjen financiare të bashkëfshatarit tonë Birçe Ribaj.

Kanë kaluar shumë vite dhe ato vazhdojnë të pëlqehen e të dëgohen me të



njëjtën dashuri. Publikimi i tyre gjatë këtyre ditëve të fundit ka zgjuar interes jo vetëm te kallaratasi, por edhe te shumë miq e dashamirës tanë, gjë që dëshmohet qartë nga fakti se secila këngë është shpërndarë në mbi 30 adresa e statuse të ndryshme.

Falënderim dhe mirënjohje për të gjithë ata që punuan dhe realizuan këto këngë të bukura në vitin 1995, këngë që mbeten të gjalla, të dashura dhe tërheqëse edhe sot!

Faleminderit gjithashtu të gjithë komentuesve dhe shpërndarësve të këngëve në profilet e tyre!
TË RINGJALLIM ZËRIN TONË!

Kallarati ka pasur dhe vazhdon të ketë këngëtarë të dëgjuar të këngës labe. Pa u kthyer

shumë larg në kohë, le të ndalemi te Festivali Folklorik i Gjirokastrës i vitit 1983, ku Kallarati u paraqit me dy perla të vërteta: "Ç'u këput një këmbë mali", kënduar nga i paharruari, këngëtar i madh Zeqo Hoxhaj (ndarë nga jeta) dhe "Djepi ynë burim flori", kënduar nga këngëtarja me zë të veçantë Evgjëni Jonuzaj, këngë këto të vlerësuara nga juria e festivalit.

Ndërsa kulmi i përfaqësimit të Kallararit në shkallë kombëtare mbetet emri i madh i "Bilbilit të Labërisë", Hyso Xhaferaj (ndarë nga jeta), pjesë e Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe e shumë grupeve të tjera artistike, duke mbetur një nga figurat më të ndritura të këngës sonë.

Po kështu kemi këngëtarin e muzikës popullore, por edhe të këngës labe, Gjergji Leskaj, me albumin e tij "Jam bir nga Labëria", këngëtarin Andon Begaj, pjesëmarrës aktual në shumë grupe labe jashtë Kallararit, si edhe plot këngëtarë të tjerë, që edhe pse nuk kanë mundur të çajjnë në tregun e vështirë shqiptar të viteve të demokracisë dhe ekonomisë së tregut, mbeten po aq të vlerësuar dhe të dashur sa edhe emrat më të njohur.

Kur ishin të gjithë bashkë, me Hyson dhe Zeqon, edhe pse ishin bërë plane për të incizuar disa këngë si grup i "Bogonicës", kjo nuk u bë e mundur, qoftë për neglizhencë, qoftë për mungesë organizimi dhe mbështetjeje financiare.

Megjithatë, sot nuk është koha të ankohejmë për atë që nuk u bë. Sot është koha të mendojmë për atë që mund dhe duhet të bëjmë.

Dy vitet e fundit, me organizimin e "Piknikut Pranveror" në Fshatin e Djegur, nisi sërish një ringjallje e bukur e grupit. Të veshur me kostumet tradicionale, këngëtarët tanë ndezën zjarrin e kujtimeve dhe të krenarisë sonë, sollën jehonën e të parëve dhe zgjuan në zemrat tona një dëshirë të thellë: të ringjallim grupin artistik "BOGONICA".

Kënga nuk ka vdekur!

Zëri i Kallararit jeton!

Sot kemi një brez të ndërthurur bukur, me të vjetër e të rinj, me zëra të fuqishëm e të talentuar si: Gjergjin, Andonin, Renaton, Bakon, Simonin, Vangjelin, Arjanitin, Lisandrin, Brahimin, Kastriotin, Agurimin, si dhe femrat: Evgjëninë, Elenën, Largimen, Festimen, Bejazen, Asqerinë, Hasimenë, Mazetën e shumë të tjerë, të cilët mezi presin të këndojnë sërish nën një emër të vetëm: "BOGONICA".

Por ata presin dikë që t'i mbledhë, t'i organizojë dhe t'u japë drejtim. Evgjënia dhe Renato, edhe pse janë më larg, janë të gatshëm, me dëshirë të veçantë, t'i bashkohen në çdo kohë grupit të Kallararit.

Pra, ne kemi dëshirën, kemi pasionin, kemi talentin, na duhet vetëm organizimi, udhëheqja artistike dhe mbështetja financiare për t'i kthyer Kallararit këngën dhe vallen.

TË RINGJALLIM ZËRIN TONË!

VELIKO MURATI

NJË FIGURË KOMPLEKSE PATRIOTIKE E FOLKLORIKE

Veliko Murati (Breshanaj), u lind në Kallarati më 1888. Mbaroi shkollën e mesme turke në Janinë. Mori pjesë në luftimet kundër bandave të andartëve grekë më 1914 dhe kundër pushtuesve italianë në Luftën e Vlorës më 1920. Me mbarimin e Luftës, u dërgua nga Ismail Qemali në Himarë, ku qëndroi dy muaj, së bashku me Gani Iliazin e Meçan Selamin, për të punuar kundër grekofilëve të Bregut. Ka qenë për shumë vite kryeplak i fshatit. U bashkua me Lëvizjen Antifashiste dhe në mars 1943 u zgjodh anëtar i Këshillit Antifashist të krahinës. Më vonë, u largua nga radhët e Lëvizjes. U dënua me pushkatim në qershor 1944. Rapsod i njohur në Kurvelesh e Labëri për këngët e ndjera patriotike kushtuar luftërave të krahinës kundër pushtuesve grekë e italianë. (Shkëputur nga libri “Enciklopedia e Kurveleshit”)

Por nëpërmjet emisionit “Autokton” u njohëm me fakte dhe dëshmi të rëndësishme mbi historinë dhe

veprimtarinë e Veliko Muratit – një figurë historike dhe patriotike, por edhe krijuese, që përbën një rast disi të veçantë në historinë e Kallaratit, figure e cila pas viteve 90-të, ndryshe nga vitet e mëparshme, aktiviteti i tij ndaj vendlindjes është pasqyruar në “Enciklopedinë e Kurveleshit”, gazetën “Kallarati”, “Historikun e Kallaratit” shkruar nga Enver Strati, në uebsajtin www.kallarati.com, në fejsbuk dhe gazetën “Kallarati”, por që emisioni “Autokton” dhe intervistuesit i dhanë një qasje të re dhe një kujtesë për brezat e rinj, në mënyrë të veçantë për pushkatimin e tij dhe të djalit, Qamil Breshanaj, ish partizan.

Ngjarjet duhen njohur dhe përcjellë ashtu siç ka qenë në të vërtetë, duke u mbështetur në burime historike të shkruara, dokumente arkivore dhe dëshmitë e atyre që e kanë jetuar kohën. Vetëm kështu ruajmë dinjitetin e kujtesës dhe u japim brezave një histori të saktë, të plotë dhe të paanshme.



YLLI FADIL BRESHANI FALËNDERON

Përsëritës stafin e televizionit News 24 në veçanti vajzën e shkëlqyer nga Brati, Anila Ahmataj dhe regjizorin Ardit Zotaj, një djal i mbrekullueshëm nga Gorrishiti për punën dhe ndihmën e pakursyer në realizimin e këtij dokumentari në kujtim të të parëve të mi. Si trashgimtar i drejtpërdrejtë unë jam njeri nga femijët e Fadilit, të vetmit fëmijë që mbijetoi nga martesja e Qamilit me gjyshen time Laloten nga Sadikajt e Bolenës dhe kontribues në realizimin e këtij dokumentari së bashku me djemët e Petritit dhe mbështetjen e Koços së Lumit edhe ky një nip i drejtpërdrejtë yni. Falenderojmë të gjithë ata bashkfishatarë dhe jo vetëm nga Kallarati që ndihmuan sado pak në zbardhjen e së vërtetës së vrasjes pa gjyq të gjyshit dhe stërgjyshit nga ai sistem bolshevik. Unë jam krenar që jam nga Kallarati, një fshat me njerëz shumë të mirë, që nuk ja prishin dot fytyrën disa njerëz si ata që çuan në pushkatimin e Velikos me të cilin krenohej fshati dhe krahina, pushkatimin e Qamilit një djal shumë i ri që kishte dalë partizan dhe këta e pushkatuan në emër të bolshevizmit, këta njerëz kriminelë që kurrë nuk ndien pendesë akoma dhe fara që kanë lënë pas nuk gjetën kurajon të kërkojnë një ndjesë për llogari të baballarëve të tyre kriminel, si duket ja u kanë futur shumë thellë farën e kuqe të bolshevizmit. Falenderoj dhe përsëritës gjithë bashkfishatarët e mi kallarratas kudo ku që janë për respektin dhe mbështetjen që na kanë dhënë edhe sot në kujtimin e të parëve të mi dhe në vitet vështira të komunizmit. Babai im Fadili mbeti 4 vjeç jetim, u martua me Sabren nga fisi i nderuar i Stratajve të cilët i përsëritës dhe rritën 9 fëmijë dhe sot ja ku jemi, e drejta vonon po nuk harron, lum kush e ka kokën lartë dhe mjerë kush ka turp të shikojë në sy. I paharruar kujtimi Veliko dhe Qamil Breshani! Krenar që jam nipi i atyre burrave që shumë do e kishin zili. (Marrë origjinal nga fejsbuku)



Falenderojmë të gjithë ata bashkfishatarë dhe jo vetëm nga Kallarati që ndihmuan sado pak në zbardhjen e së vërtetës së vrasjes pa gjyq të gjyshit dhe stërgjyshit nga ai sistem bolshevik. Unë jam krenar që jam nga Kallarati, një fshat me njerëz shumë të mirë, që nuk ja prishin dot fytyrën disa njerëz si ata që çuan në pushkatimin e Velikos me të cilin krenohej fshati dhe krahina.

VELIKO MURATI - PATRIOTI DHE VJERSHËTORI POPULLOR



– NGA LAVDOSH QEJVANI

*“Ç’gjet Veliko Muratë
Pse nuk e kemi dëgjuar
Ka vdekur a është gjall
Mo po ish dhe vjershëtuar...”*


Lumi i historisë njerëzore që rrjedh pandërprerë, në dimrin e tij, shkulet dhe del nga shtrati, mbushur nga shirat emocionalë dhe të kufizimeve ideore. Por pas dimrit vjen pranvera, që kthjellon ujrat dhe e pastron atë nga ngarkesat e tepërta të stinës politike...!

Historia nuk është statike, por një proces i vazhdueshëm interpretimi, dhe me rënien e Murit të Berlinit në vitin 1989, ndryshoi konteksti social dhe politik në Europën Lindore dhe rrjedhimisht edhe në Shqipëri. Ndaj edhe vështrimet retro janë të domosdoshme dhe të justifikuar deri në atë masë, që të mos shkojnë në ekstremin tjetër të idealizmit! Ky shkrim nuk është një investim emocional, por i bazuar mbi një logjikë të ftohtë që të jep distanca kohore e 80 e kusur viteve, dhe as mund të bëhet fjalë që mund të ketë prapavijë ekonomike...!

Në skajet e historisë sonë, aty ku kujtesa kolektive mjugullohet, ku dhe zërat veniten, në periferinë e heshtjes, qëndron figura e një patrioti dhe vjershëtori popullor, emri i të cilit është kyçur në sirtarin me boshllëqe të narrativave zyrtare. Ai nuk ishte domosdoshmërisht një hero në kuptimin klasik të fjalës, as figurë që gjeti strehë në tekstet shkollore, por një individ kompleks i mishëruar me kontradikta, bindje dhe veprime që nuk i përshtateshin gjithmonë rrefimit zyrtar të kohës...! Ndonëse edhe sot janë disa që vështirësohen akoma ta shohin atë. Rrefimi për të kërkon të rikonstruktohet mes fragmenteve, kujtimeve të shpërndara dhe heshtjes së gjatë që e ka mbuluar. Duke sjellë në dritë Veliko Muratin, nuk i rikthejmë kujtesës së komunitetit vetëm një protagonist të merituar, por sfidojmë edhe mënyrën se si zgjedhim të kujtojmë dhe të harrojmë.

Një dokumentar televiziv para ca kohësh, strukturuar mbi koncepte mediatike, ishte tentativa e parë, për të shkundur pluhurin e kohës.

Veliko Murat Breshani lindi në 18 prill të vitit 1888, në Kallarat të Vlorës, në një krahinë të trazuar dhe të ndikuar nga ngjarjet historike të kohës. Në Pilingri, rrëzë Bogonicës kryelartë do të kalonte vitet e para të fëmijërisë. Vendi ku u rrit, të jepte mundësinë që të shihje pothuaj gjithë luginën e Lumit të Vlorës, por kureshtja dhe etja për dije e tij, shikonin përtej horizontit gjeografik dhe kohor. Mësimet e para do t'i merrte në



shkollën e Kuçit. Në formimin e tij arsimor mund të thuhet se ishte me fat. Më tej mori mësim në Ruzhdiye të Pargës, dhe më pas përfundoi gjimnazin turk të Janinës, shkollë kjo që i zgjeroi horizontet dhe i dha lexime dhe kontakte patriotike. Gjimnazi turk i Janinës, Yania Idadisi ishte një nga shkollat më të rëndësishme osmane në rajonin e Epirit, së bashku me gjimnazin grek Zosimea. Në gjimnazin turk të Janinës kishin studiuar një numër i madh i elitës shqiptare të fillimit të shekullit të kaluar, ndër të cilët edhe Mehdi Frashëri, Eqrem Vlora, Xhafer Ypi, Ali Këlcyra dhe shumë të tjerë, që më pas u bënë personalitete të administratës osmane ose figura politike në shtetet që dolën nga rënia e Perandorisë Osmane.

Me një formim arsimor nga më të mirët e kohës, me një ndjenjë të lartë atdhedashurie dhe talentin që i kish falur zoti, do të shkruante historinë e tij.

“Ditë e natë nëpër male

Me dhën dhe me dhi

Shtruar nëpër përralle

Me libra në gji

Duam të na hapet shkolla

Duam dituri”

Në thelb, këto vargje janë miniaturë poetike e shoqërisë shqiptare të kohës: të varfër në kushte, por të pasur në aspirata. Arsimimi do ti kultivonte mendim të pavarur dhe aftësi kritike, komunikimi dhe bashkëpunimi. Ai ishte një personalitet shumëdimensional, ku mbi të gjitha spikat patriotizmi dhe krijimtaria. Para shpalljes së Pavarësisë u angazhua në lëvizjen patriotike, ku krijoi lidhje të ngushta me patriotët të kohës,

duke kaluar vite në Korfuz dhe Korçë. Për fat të keq informacionet për të janë të pakta, edhe për faktin se jemi të vonuar, pasi të gjithë dëshmitarët okularë si gjeneratë kanë shkuar në amshim. Mori pjesë në kryengritjet e armatosura para Pavarësisë të viteve 1909-1911, në shpalljen e saj në vitin 1912, në luftë për të ruajtur integritetin e shtetit të ri shqiptar në vitet 1913-1914, gjithashtu edhe në Luftën e Vlorës (1920).

*“O Sazan të keqen unë
Pse rënkon kaq shumë
Apo sheh Vlorën për lumë
Shqipëria të ka humbë...”*

Vargje me imazhe dramatike, me ngarkesë të fortë lirike dhe simbolike, ku natyra bëhet pasqyrë e fateve të vendit. Autori, protagonist në këto ngjarje historike, krijon një elegji të fuqishme për fatet e atdheut.

Ishte një zë me rezonancë krahinore, por edhe më tej. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u bashkua me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në mars të vitit 1943 u zgjodh anëtar i Këshillit Antifashist të rajonit të Kurveleshit. Ai ishte dhe ngeli deri në fund të jetës një patriot i shquar, sa antifashist, po aq edhe antikomunist! Ngjarjet e mëpasme, duke kuptuar ligjet e luftës, nuk mund të shpjegohen në mënyrë sporadike, por duke parë të plotë tablonë e teatrit politik dhe luftarak të kohës. Në 16 shtator të vitit 1942 u mbajt Konferenca e Pezës, një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, që shënoi përpjekjen e parë serioze për bashkimin e forcave të ndryshme politike dhe patriotike për çlirim kombëtar, pa

dallim feje, krahine dhe ideje, në të cilën u hodhën themelet e Frontit Nacionalçlirimtar. Në nëntor të vitit 1942, dy muaj pas Konferencës së Pezës, në fshatin Krutje të Lushnjës themelohet Balli Kombëtar, me qëllim që të luftonte për çlirimin e vendit dhe krijimin e një Shqipërie etnike pas luftës. Në 1-2 gusht të vitit 1943, në prag të kapitullimit të Italisë fashiste, do të mbahej e ashtuquajtura Mbledhja e Mukjes, midis Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar, e cila mori vendime të rëndësishme, por më pas nën ndikimin e faktorëve ndërkombëtarë si dhe të dallimeve politike dhe ideologjike, dështoi. Nga përpjekja për unitet kombëtar, u kalua në përçarje dhe konflikt të brendshëm, që ndikoi në zhvillimet politike të mëvonshme në Shqipëri. Në shtator të vitit 1943 mbahet Konferenca e Labinotit, e cila shënoi një hap të rëndësishëm drejt centralizimit të drejtimit të luftës dhe konsolidimit të pushtetit të forcave partizane. Pikërisht këtu rrugët ndahen, krijohen tensione, që në disa raste shoqërohen edhe me episode luftarake. Në këtë kontekst politik luftarak do të ndodhte edhe hapi i hedhur nga Veliko Murati, duke u distancuar nga Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar, por jo duke ngritur armë ndaj tij. Thuhet, që në ditët e para, që merr këtë vendim të rëndësishëm të jetës, i shkon një darkë në shtëpi Hysni Kapua dhe Velikua i kumton ndryshimin në pozicionimin e tij ndaj aktorëve të luftës. Hysniu, me të dëgjuar ngrihet në këmbë dhe i thotë atëherë duhet të iki që tani, por Velikua i thotë je mik në shtëpinë dhe besën time dhe sot do të gdhiesh këtu. Dhe ashtu ndodhi, Hysniu u ngrit dhe iku të nesërmen herët në mëngjes. Ai duke e ditur se çfarë ishte komunizmi, dhe duke parë fantazmën e tij në horizont duke ardhur, që shumica nuk e shikonte dhe e kuptonte, por që do ta vuante më pas, doli kundër. Zgjuarsia dhe formimi i tij, për herë të parë dhe të fundit nuk do të ishin aleat me të, dhe për fat të keq do të vendosnin fatin e tij njerëzor. Qesëndia e tij shpotitëse, që u bënte partizanëve për yllin e kuq në kapelet e tyre “çë kini atë domate në kësulë?!“ do t'i kushtonte jetën...! Dhe jo vetëm atij, por edhe djalit të tij Qamilin, që do të pushkatohej në Kuç nga partizanët në verën e vitit 1944. Sipas thëniesve të nënës sime, si dëshmitare reale, kur po shkonin Qamilin për në Kuç për pushkatim partizanët, në Qafën e Ubavit u doli përpara gjyshja ime përpara, motra e Veliko Muratit, në zhegun e vapës ku digjej stralli, dhe u thotë partizanëve: - daleni more djema t'i jap nipit një çanak me dhallë...”, ku më pas do të shkruhej edhe epilogu i kësaj tragjedie! Ky ishte fundi tragjik dhe i pamerituar i jetës fizike së Veliko Muratit, dhe për fat të keq të njëjtin fat dhe dënim heshtjeje do të kishin edhe vjershat e tij! Veliko Murati ishte edhe një vjershëtor popullor, një këngëtar dhe poet i vetëdijshëm për periudhën e trazuar që jetonte. Ai nuk ishte vetëm krijues, por edhe një kronikan i shpirtit të kohës së tij. Këngët e tij me një tematikë të larmishme, me vargje epike, reflektuan vuajtjet, dashurinë për atdheun dhe për arsim, krenarinë dhe rezistencën e krahinës dhe mbeten pjesë e çmuar e folklorit lokal dhe i japin zë një historie që shpesh nuk shkruhej në libra, por jehohej në këngë, valle dhe tubime.

I japin zë dhe imazh historik edhe autorit të tyre, patriotit të shquar dhe vjershëtorit popullor Veliko Murat Breshanit...!

IN MEMORIAM

Në kujtim të 10-vjetorit të ndarjes nga jeta të vëllait, Refat Rjepaj

- Nga Violeta Xhaferaj -

I dashur vëllai im, Refat!

U bënë plot 10 vjet që motra nuk të sheh. Prapë nuk e besoj dot që s'më vjen në shkallë e në portë, ashtu duke qeshur me atë hijeshinë dhe fisnikërinë tënde, e të më flisje si gjithmonë: "O motra ime, mavri!"

Vëlla, më ke vuajtur shumë. Ku nuk patën shkelur këmbët e tua: mal më mal e në vërrë – Pogon, Bogonicë, Delvinë e në vende që unë as nuk i di.

Në fund, me shumë mund e djersë, ngrite jetën dhe punën tënde në fushë të Butrintit. Zëre se ishe në kurbet, se nuk njihje njeri, por me zotësi, dinjitet e mençuri u bërë njësh me njerëzit e atij vendi, në gëzimet dhe hallet e tyre, ashtu si edhe ata me ty.

Në krah të dolën djemtë e tu, që u bënë edhe më të mirë e më të zotë se ti, vëlla i dashur Refat.

Ti ishe shumë pritës e bujar. Si ti nuk kishte njeri. Dyert e shtëpisë tënde janë hapur edhe sot, njësoj sikur je ende aty.

Dua shumë të flas e të shkruaj për ty, sa shpirti ma di.

Prehu i qetë në Bredenesh, se aty ke familjen tënde.

Mos ki merak për djemtë, se kanë ecur përpara dhe të nderojnë çdo ditë.


Vij të të uth e të të përqafoj, por Ti ftohtë më rri...

Sot bëhen 10 vite që nga dita kur gjyshi im u nda nga jeta. Edhe pse koha kalon, kujtimet dhe dashuria për të mbeten gjithmonë të gjalla në zemrat tona.

Ai ishte një njeri i mire, i urte dhe gjithmonë pran familjes. Na mësoi shume gjera për jetën, për respektin dhe për dashurin ndaj njëri tjetrit. Edhe pse nuk ishte me fizikisht mes nesh, kujtimi i tij do të jetojë gjithmonë në familjen tone.

Sot e kujtojme me mall, respekt dhe shumë dashuri. U preh në paqe gjyshi ynë i dashur.

Do të mbetesh gjithmonë në zemrat tona. ❤️🙏



Edhe Alesia, vajza e Dorianit (edhe pse e ka lënë vetëm 3 vjeçe), në statusin e saj në këtë përvjetor të 10-të gjyshit shkruan:

Sot bëhen 10 vite që nga dita kur gjyshi im u nda nga jeta. Edhe pse koha kalon, kujtimet dhe dashuria për të mbeten gjithmonë të gjalla në zemrat tona.

Ai ishte një njeri i mirë, i urtë dhe gjithmonë pranë familjes. Na mësoi shumë gjera për jetën, për respektin



dhe për dashurinë ndaj njëri - tjetrit.

Edhe pse nuk është më fizikisht

mes nesh, kujtimi i tij do të jetojë gjithmonë në familjen tonë.

Sot e kujtojmë me mall, respekt dhe shumë dashuri.

U prehsh në paqe, o gjyshi ynë i dashur!

Do të mbetesh gjithmonë në zemrat tona.

IN MEMORIAM

HASAN JONUZAJ,
NJË NGA BLEGTORËT E
SHQUAR TË KALLARATIT

Njeriu i punës, i sakrificës, i dinjitetit dhe i karakterit të fortë -

Profesioni i çobanit nuk ka qenë kurrë i lehtë. Është profesion mundi, vetmie, përgjegjësie dhe sakrifice; një jetë e kaluar maleve, staneve, në vapë e në të ftohtë, larg rehatisë dhe shpesh larg familjes, por njëkohësisht edhe një profesion i nderuar dhe i respektuar.


Kallarati ka pasur shumë çobanë të nderuar në periudha të ndryshme, por Hasan Jonuzaj mbetet një nga figurat më të spikatura, një nga legjendat e këtij profesioni, të cilin e ushtroi me dinjitet të rrallë, duke u kthyer në shembull për brezin e ri të çobanëve kallaratas dhe të gjithë zonës.

Ai e kaloi jetën staneve të Valit e Bogonicës, me punë të palodhur, me djersë e sakrifica, por gjithmonë me kokën lart. Ishte njeri i drejtë, i prerë në fjalë, i papajtuëshëm me padrejtësitë e kohës dhe me çdo gjë që binte ndesh me karakterin e tij. Nuk ishte njeri që përkulej lehtë; kishte bindjet e veta, krenarinë e vet dhe dinjitetin që e ruajti deri në fund të jetës. Së bashku me bashkëshorten e tij, Behon, rriti, edukoi dhe arsimoi tetë fëmijë, duke lënë pas një trashëgimi të çmuar familjare, njerëzore dhe morale. Gjurmët e tij mbeten të paharruara jo vetëm te fëmijët, nipërit e mbesat, por edhe te ne bashkëfshatarët që e kemi njohur dhe e kujtojmë me respekt.

Me të drejtë, në këtë 23-vjetor të ndarjes nga jeta, Hasan Jonuzaj kujtohet me krenari, mirënjohje dhe nderim, jo vetëm nga mbesat dhe familjarët e tij, por nga të gjithë ata që e njohën dhe e vlerësuan.

Ai mbetet shembulli i njeriut të thjeshtë, por me vlera të mëdha; i çobanit të palodhur, i prindit sakrifikes dhe i burrit që jetoj me karakter të fortë e të pathyeshëm deri në fund të jetës së tij.

Njerëz të tillë janë të rrallë sot. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij!



Kryesia e Shoqatës "Kallarati" u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të singerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. Qofshin të paharruar!

IN MEMORIAM

PËR BABGJYSHIN TIM
TË PAHARRUAR HASAN
JONUZAJ (KALLARATI)

- NGA ANILA MUKAJ -

Ka njerëz që jetojnë një jetë të tërë dhe lënë pas vetëm kujtime. Ka të tjerë që lënë gjurmë, vlera dhe një trashëgimi shpirtërore që i mbijeton kohës. Ti, gjyshi im, i përkisje kësaj kategorie të rrallë. Ti jetove në një kohë që nuk i përkiste madhësisë së mendjes sate. Ishte një sistem që kërkonte bindje, ndërsa ti kishe mendim; që kërkonte heshtje, ndërsa ti kishe bindje të forta; që kufizonte lirinë, ndërsa ti shikoje përtej kufijve që të tjerët nuk arrinin t'i shihnin. Nuk u pajtove kurrë me padrejtësinë, por zgjodhe ta përballoje jetën me dinjitet, krenari dhe fisnikëri.

Ti ishe një hero i heshtur. Nuk ankoheste, nuk kërkoje lavdi dhe nuk përkuleshe para vështirësive. Me punë të ndershme, mençuri dhe sakrificë arrite të bësh atë që dukej e pamundur: të rrisje dhe të arsimoje tetë fëmijë, duke u dhënë armën më të fortë që mund t'u jepte një prind - dijen. Shumë njerëz të konsideronin të vështirë, sepse jo të gjithë mund ta kuptonin thellësinë e karakterit tënd. Por ata që patën fatin të të njihnin nga afër, zbuluan një njeri me zemër të madhe, me mendje të hapur dhe me një aftësi të rrallë për të parë dekada përpara kohës së vet. Ti e kuptoje realitetin me një qartësi që sot na habit ende.

Nuk njihje zilinë, ligësinë apo intrigat. I vlerësoje njerëzit për ndershmërinë, mençurinë dhe arritjet e tyre. Ishe i drejtëpërdrejtë, krenar dhe i vërtetë në çdo fjalë e veprim. Vlerat e tua nuk ishin thjesht fjalë; ishin mënyra se si e jetove jetën.

Sot, sa më shumë kalojnë vitet, aq më tepër kuptojmë sa i veçantë ishe. Shumë nga ato që mendoje dhe parashikoje janë bërë realitet. Kjo është arsyeja pse mungesa jote ndihet ende, por edhe pse kujtimi yt bëhet më i madh me kalimin e kohës. Ti nuk na le pas pasuri materiale. Na le diçka shumë më të çmuar: shembullin e një njeriu që jetoi me dinjitet, punoi me ndershmëri, mendoi lirshëm dhe mbeti besnik ndaj vetes deri në fund.

Prehu në paqe, gjyshi im i dashur. Kujtimi yt jeton në zemrat tona, në vlerat që na mësove dhe në respektin e pafund që kemi për ty. Koha nuk e zbeh figurën tënde; përkundrazi, e bën edhe më të ndritur.

*I paharruar qoftë emri dhe kujtimi yt, BABGJYSH!
BABGJYSH: dy emra të shtrenjtë në Një: BAB dhe
GJYSH! Ky ishe për ne ti gjyshi ynë i dashur!*

NË PËRKUJTIM TË NJË VJETORIT TË NDARJES
NGA JETA TË FATMIR SALO MATAJ

Një vit më parë u nda nga jeta Fatmir Mataj, mësues i përkushtuar, intelektual i ndershëm dhe bir i denjë i Kallaratis. Ai i përket atij brezi njerëzish që jetuan me ndjenjën e detyrës, të përgjegjësive dhe të dashurisë për dijen e arsimin.

Për më shumë se katër dekada, Fatmiri shërbeu me devotshmëri në shkollat ku punoi nga veriu, në Lumin e Vlorës e në fund në qytetin e Vlorës, duke edukuar e formuar breza të tërë nxënësish dhe duke lënë gjurmë të pashlyeshme jo vetëm si mësues i historisë, por edhe si drejtues shkolle, koleg korrekt dhe njeri me parime të forta morale.

Ai ishte shembull i profesionalizmit, korrektësisë dhe respektit ndaj figurës së mësuesit në shoqëri.

Edhe pas daljes në pension, Fatmiri nuk u shkëput nga jeta shoqërore dhe mbeti i lidhur ngushtë me vendlindjen, me qytetin e Vlorës dhe me Shoqatën "Kallarati", duke dhënë gjithmonë mendimin e tij të matur dhe dashamirës.

Sot, një vit pas ndarjes së tij të parakohshme nga jeta, Fatmir Mataj jeton në kujtesën e familjes, të nxënësve, të kolegëve dhe të bashkëfshatarëve të tij, përmes veprës, emrit të mirë dhe shembullit që la pas.

Kryesia e Shoqatës "Kallarati" kujton me respekt të thellë Fatmir Matajin dhe i shpreh familjes së tij ngushëllimet më të sinqerta. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij!



IN MEMORIAM

DEDIKIM NË KUJTIM TË NJËVJETORIT TË
NDARJES NGA JETA TË DORJAN DEMIRIT (DORIT)

Më 20 shkurt 2026 në njëvjetorin e largimit të parakohshëm nga jeta, përulemi me dhimbje dhe respekt para kujtimit të Dorjan Demirit - Dorit tonë të dashur, siç e thërrisim të gjithë.

Dori ishte një nga bijtë më të mirë të Kallaratis - buzagaz, fjalëmbël, inteligjent dhe me një shpirt të pastër që rrezatonte mirësi. Edhe përballë një beteje të gjatë e të vështirë me sëmundjen, ai nuk e humbi kurrë dashurinë për jetën, për njerëzit dhe për vendlindjen e tij të shtrenjtë, Kallaratin.

Ai mbeti gjithmonë Dori i zemrës, me buzëqeshjen e ngrohtë, humorin e hollë dhe forcën e shpirtit që frymëzonte të gjithë ata që e rrethonin.

Largimi i tij i parakohshëm la një boshllëk të madh te prindërit, vëllai, motrat, nipërit e mbesat, te miqtë, shokët dhe te gjithë kallaratasit dhe jo vetëm, por kujtimi i tij do të jetojë përherë në zemrat tona.

Në këtë ditë kujtese, ndajmë dhimbjen me familjen Demiraj dhe u shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta.

Kujtimi i Dorit tonë të dashur do të mbetet i përjetshëm.

Fjalët janë të pakta, por dashuria dhe nderimi për të janë të pafundme.

U prehtë në paqe, Dori ynë i dashur! Qoftë i paharruar kujtimi i tij!

Kryesia e Shoqatës "Kallarati"



Kryesia e Shoqatës "Kallarati" u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. Qofshin të paharruar!

IN MEMORIAM

DEDIKIM NGA MBESA MIMOZA LAMAJ, PËR GJYSHIN E SAJ TË DASHUR, SALI MEMUSHAJ, ME RASTIN E 7-VJETORIT TË NDARJES NGA JETA

Sot bëhen 7 vite që ti nuk je më pranë nesh, gjyshi ynë i dashur Sali. Koha kalon, vitet ikin, por mungesa jote mbetet po aq e madhe në zemrat tona. Na mungon zëri yt, përqafimi yt i ngrohtë, buzëqeshja jote dhe prania jote e dashur në familje. Edhe pse nuk të shohim më, kujtimet me ty jetojnë çdo ditë brenda nesh. Ti mbetesh i paharruar, i dashur dhe i nderuar, ashtu siç ishe gjithmonë për familjen tënde.

Prehu në paqe, gjyshi ynë i shtrenjtë! Të kujtojmë përherë me mall, respekt dhe dashuri.

Mbesa jote, Mimoza Lamaj



IN MEMORIAM

NË 12-VJETORIN E NDARJES NGA JETA TË GAFUR HASAN SHAMETAJ

Në 12-vjetorin e ndarjes nga jeta, familja, Kryesia e Shoqatës “Kallarati” dhe gjithë ata që e njohën e vlerësuan, kujtojnë me respekt e mirënjohje të ndjerin Gafur Hasan Shametaj, një nga nismëtarët e themelimit të Shoqatës “Kallarati”, kryetarin e parë të saj dhe kryeredaktorin e parë të gazetës “Kallarati”.

Gafur Shametaj mbetet në kujtesën tonë si intelektual i përkushtuar, njeri i fjalës së mençur, i humorit të hollë, i kulturës dhe i bashkimit. Me punën, vizionin dhe përkushtimin e tij, ai dha një kontribut të çmuar për Kallaratin, Vlorën, Labërinë dhe më gjerë.

Në krye të Shoqatës “Kallarati”, ai punoi me maturi, dashuri e përgjegjësi, duke e mbajtur shoqatën larg ndasive dhe duke e orientuar gjithmonë drejt bashkimit të kallaratasve, ruajtjes së traditave, historisë dhe vlerave të vendlindjes.

Me ndarjen e tij nga jeta 12 vite më parë, familja humbi njeriun e saj të shtrenjtë, shoqëria mikun e mirë, kultura krijuesin e talentuar, ndërsa Shoqata “Kallarati” një nga themeluesit dhe veprimtarët më të përkushtuar të saj.

Kujtimi dhe kontributi i Gafur Hasan Shametajt do të mbeten gjithmonë të paharruara.

I paharruar qoftë emri dhe vepra e tij!



Kryesia e Shoqatës “Kallarati” u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të singerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. Qofshin të paharruar!

IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA
NAMAZ FERIK TOZAJ

Më 12 shkurt 2026 u nda nga jeta në moshën 82-vjeçare, të Namaz Ferik Tozaj, bashkëshortit i Dylberes; baba i Arifit, Pëllumbit, Marenglenit, Dianës dhe Altinës; vëlla i Nasipit, Dodos (i ndarë nga jeta), Asqerisë, Alekos dhe Pajtimit.

Namazi lindi në Kallarat më 17 shtator 1943, në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e atdhetare të fisit Tozaj, nga prindërit Ferik dhe Merjo.

Si gjithë moshatarët e tij kallaratas, u rrit mes sakrificash dhe vështirësish, por gjithmonë me dashuri për punën, njerëzit dhe vendlindjen.

I martuar me Dylberen nga fisi i dëgjuar Jonuzaj i Kallaratis, së bashku ndërjuan një familje të shëndoshë dhe edukuan me përkushtim tre djem dhe dy vajza.

Gjatë jetës punoi në sektorë të ndryshëm të kooperativës, si në bujqësi ashtu edhe në blegtori, duke u shquar për përkushtim dhe ndershmëri. Më pas, së bashku me bashkëshorten Dylberen, në kushtet e ekonomisë së tregut, ngritën me djersë e mundim ekonominë private blegtorale.

Përveçse punëtor i dalluar, Namazi ishte pjesëmarrës në aksione të rinisë, aktiv në organizatat shoqërore të fshatit, pjesëtar i grupit artistik dhe për shumë vite komandant i çetës vullnetare të Kallaratis.

Gjatë punës në kooperativë u aksidentua rëndë, duke humbur njërin dorë, por kjo nuk e ndali kurrë, ai vijoi të punojë dhe t'i përshtatet kushteve të reja të jetës, duke pasur edhe statusin e invaliditetit.

Vitet e fundit u përball edhe me sëmundje të tjera që ia rënduan shëndetin, por jo kurajon dhe dinjitetin.

Namazi ishte gjithashtu një veprimtar i shquar i Shoqatës “Kallارات”, duke kontribuar me shkrime dhe kujtime nga historia e fshatit, falë memories së tij të veçantë. Ishte i pranishëm në çdo aktivitet, edhe pse me shëndet të brishtë, gjë të cilën ia diktonte dashuria për vendlindjen dhe njerëzit.

Sëmundja e rëndë dhe e gjatë e ndau nga familja dhe shoqëria, por duke lënë pas një emër të mirë.

Kryesia e Shoqatës “Kallارات” i shpreh familjes, bashkëshortes, fëmijëve, nipërve e mbesave, vëllezërve, motrës dhe gjithë fisit Tozaj ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e njeriut të tyre të dashur.

Qoftë i paharruar kujtimi i tij! U prehtë në paqe!



IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA
ABAZ MYFTAR DAUTAJ

Më 19 qershor 2026 u nda nga jeta në moshën 91-vjeçare Abaz Myftar Dautaj; babai i Gjergjit, Ilirit dhe Rajmondës (ndarë nga jeta); vëllai i Xhelos, Hamides (ndarë nga jeta) dhe Xhixhos; bashkëshorti i Besnikes (ndarë nga jeta).

Abazi lindi në Kallarat, më 23 nëntor 1934, nga prindërit Myftar dhe Selime Dautaj, në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e atdhetare.

Fëmijërinë e kaloi, si shumë fëmijë kallaratas të asaj kohe, mes vuajtjesh e vështirësish, por me dashurinë dhe etjen për shkollim, duke marrë pjesë edhe në aksionet e rinisë për rindërtimin e vendit.

Ai u martua me Besnike Janjaj, me të cilën lindi, rritën, edukuan dhe arsimuan tre fëmijë, duke u përcjellë atyre dashurinë për njerëzit, për vendlindjen Kallarat dhe për atdheun.

Abaz Dautaj kreu Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, në degën e artilerisë kundërajrore, dhe shërbeu me përkushtim e devotshmëri për shumë vite si oficer në Vlorë, Karaburun, Lushnjë, Kavajë dhe, në vitet e fundit deri në daljen në pension, në Durrës.

Xha Abazi kishte një lidhje të ngushtë e të pandarë me vendlindjen e tij, Kallarat. Edhe pse në moshë të thyer, ai ishte ndër pjesëmarrësit më të rregullt në aktivitetet e Shoqatës “Kallارات”, duke qenë i pranishëm me fëmijët, nipërit, mbesat dhe miqtë e tij në çdo “Takim Brezash”, në Piknikun Pranveror në Fshatin e Djegur dhe në veprimtari të tjera të shoqatës. Me praninë dhe fjalën e tij, ai përcillte gjithmonë mesazhe të qarta për brezin e ri: ta duan Kallarat, ta ruajnë kujtesën dhe të mos harrojnë rrënjët.

Ai ishte shumë aktiv edhe në lagjen ku jetonte në Durrës, në organizatën e veteranëve dhe në atë të ushtarakëve në lirim.

Xha Abazi ishte njeri i dashur, gojëmbël, i urtë e fisnik, që shprehte vetëm dashuri për njerëzit, për vendlindjen dhe për atdheun.

Vitet e fundit të jetës xha Abazi jetoi me djalin e tij Gjergjin dhe nusen e tij Majlindën, si dhe me dy nipërit, Albanin dhe Geraldin, të cilët, edhe pas ndarjes nga jeta të bashkëshortes së tij, Besnikes, i ofruan kujdes, dashuri dhe shërbim të përkushtuar.

Xha Abazi largohet nga kjo jetë i vlerësuar për punën, kontributin dhe jetën e tij të ndershme. Ai largohet fizikisht, por do të kujtohet me respekt e mirënjohje nga familja, fisi, miqtë dhe bashkëfshatarët e tij si një njeri me vlera të larta njerëzore, shoqërore dhe atdhetare.

Me këtë rast, Kryesia e Shoqatës “Kallارات” i shpreh familjes dhe fisit Dautaj ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur, Abaz Dautaj.

Qoftë i paharruar kujtimi i Tij! U prehtë në paqe!

IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA
MERQES NAZIF JONUZAJ

Më 28 shkurt 2026 u nda nga jeta, në moshën 79-vjeçare, të Merqes Nazif Jonuzaj, bashkëshortit i Antonetës; babai i Almës, Rigenës dhe Endrit; vëllai i Pelivanit (ndarë nga jeta), Doshes, Bejesë, Gaziut, Inajetes, Hajriut dhe Petritit.

Merqesi lindi në Kallarat më 10 korrik 1946, në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e atdhetare të fisit Jonuzaj, nga prindërit Nazif dhe Gastere Jonuzaj.

Si gjithë moshatarët e tij kallaratas, u rrit mes sakrificash dhe vështirësish, por gjithmonë me dashuri për punën, njerëzit dhe vendlindjen.

Nga viti 1953, së bashku me prindërit, jetoi në Lunxhëri të Gjirokastrës, duke dëshmuar si familje Jonuzaj vlera të spikatura në komunitetin e atjeshëm. Pas përfundimit të shkollës së mesme, mbaroi me sukses edhe Institutin e Lartë Bujqësor, dega Veterinari, në Tiranë, dhe për një kohë të gjatë punoi me përkushtim e devotshmëri në disa detyra, si: kryeveteriner në Kooperativën e Tipit të Lartë të Novoselës; më pas veteriner në Komitetin Ekzekutiv në rrethin e Vlorës; ndërsa në vitet e demokracisë, veteriner në Portin e Vlorës.

I martuar me Antonetën, së bashku ndërjuan një familje të shëndoshë dhe edukuan me përkushtim dy vajza binjake, Almën e Rigenën, si dhe djalin e tyre të vetëm, Endrin.

Merqesi ishte njeri i dashur me familjen, me vëllezërit e motrat, me fisin Jonuzaj, si dhe i vlerësuar në punë e në shoqëri, me një dashuri të veçantë për vendlindjen, Kallarat.

Sëmundja e rëndë e viteve të fundit e ndau nga familja dhe shoqëria, por ai la pas një emër të mirë.

Kryesia e Shoqatës “Kallارات” i shpreh familjes, bashkëshortes, fëmijëve, nipërve e mbesave, vëllezërve, motrave dhe gjithë fisit Jonuzaj ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e njeriut të tyre të dashur.

Qoftë i paharruar kujtimi i tij! U prehtë në paqe!



Kryesia e Shoqatës “Kallارات” u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. Qofshin të paharruar!

IN MEMORIAM

6 MUAJ PA FERIDE BRESHANAJN -Dedikim nga fëmijët, nipërit e mbesat –

Gjashtë muaj më parë, më u nda nga jeta nëna jonë e dashur, Feride Breshanaj. Koha kalon, por kujtimi i saj mbetet i gjallë në zemrat tona, në çdo ditë, në çdo bisedë, në çdo mall që nuk shuhet.

Ajo ishte më shumë se një nënë, më shumë se një gjyshe. Ishte forca jonë, zemra e familjes, njeriu që mbajti me krenari, dashuri dhe dinjitet emrin e shenjtë NËNË.

Këto fjalë shkruhen nga mbesa e saj, Lucia Breshanaj, së bashku me të birin, Petro Breshanaj, në emër të të gjithë fëmijëve, nipërve, mbesave dhe familjarëve, me zemër të mbushur me mall, dashuri dhe mirënjohje të pafund.

Nëna jonë e dashur, mungesa jote është e madhe dhe e pazëvendësueshme për të gjithë ne. Ajo ndihet veçanërisht nga ata që të qëndruan pranë dhe u kujdesën për ty për shumë vite: Agron Breshanaj, bashkëshortja e tij Thëllëza Breshanaj dhe fëmijët e tyre Fati, Mikela dhe Marinela. Ata ndanë me ty çdo ditë, çdo çast, çdo vështirësi dhe çdo përkujdesje, me dashuri, përkushtim dhe sakrificë të rrallë.

Ti rrite plot nëntë fëmijë, së bashku me bashkëshortin tënd, me mund, sakrificë, durim dhe dinjitet. Përballove vështirësi të panumërta, por nuk u kurseve kurrë, vetëm që fëmijët e tu të rriteshin me edukatë, me dashuri dhe me ndershmëri. Mbaite dhimbje të mëdha në shpirt, sidomos kur humbe ata që ishin dritat e shtëpisë, por edhe atëherë nuk u dorëzove.

Unë, si mbesa jote, do të të mbaj gjithmonë në zemër. Do të ruaj çdo kujtim me ty, sidomos festën tonë të fundit së bashku, ditën e diplomimit tim, që u bë edhe më e bukur nga prania jote. Pak më parë kisha nisur një kapitull të ri të jetës, duke u martuar, dhe brenda meje do të mbetet gjithmonë ajo dhimbje e heshtur që nuk pata më shumë kohë të ndaj me ty gëzimet e mia.

Më je shfaqur edhe në ëndërr, me atë zërin tënd të ëmbël e të paharrueshëm, që vetëm ne nipërit e mbesat e njohim aq mirë:

“O Luci të keqen nona, hajde se do flasim.”

Një zë që nuk ngatërrohet kurrë, sepse ishte zëri yt, plot dashuri.

Një falënderim i veçantë vjen edhe nga nipërit Klevis, Graciano dhe mbesa jote Klaudia Çaushaj, sepse ti u përkushtove me gjithë shpirt që ata të rriteshin mirë, të edukuar dhe të ndjenin ngrohtësinë e një familjeje të bashkuar. Ndërsa Cristian të dërgon një puthje të madhe deri në qiell.

E dimë sa shumë i mungon edhe babait tim, Viktor Breshanaj, dhe nuses së tij, Michela Lombardi. Atij i mungon njeriu me të cilin qeshte, bënte shaka, fliste në telefon dhe gjente gjithmonë ngrohtësi. Ai, me natyrën e tij lozonjare, plot jetë, me mënyrën e veçantë për të të bërë të qeshje, ishte djali që të sillte buzëqeshje dhe të lehtësonte mendimet. Ajo lidhje e veçantë jeton ende, por mungesa jote ndihet çdo ditë.

Nga ana e djalit tënd Petro Breshanaj dhe bashkëshortes së tij Vjollca Breshanaj, mbetet i gjallë kujtimi i një nëne që ishte zemra e shtëpisë: sofrat e shtruara me dashuri, vaktet e ndara së bashku, fjalët e thjeshta, por plot urtësi. Ata kujtojnë duart e tua të palodhura, vështrimin tënd të kujdeshëm dhe ato momente të bukura kur mjaftonte pak për të qenë të lumtur: një darkë bashkë, një e qeshur, prania jote.

Ti kishe një forcë të heshtur, një guxim të rrallë dhe një zemër që gjithmonë i vendoste fëmijët



në radhë të parë, pa kërkuar kurrë asgjë në këmbim. Pikërisht këto kujtime sot na mungojnë më shumë, sidomos kur dikur të gjithë mblidheshim rreth teje. Me kalimin e kohës kuptohet edhe më shumë sa e rëndësishme ishte ti për bashkimin e familjes.

Të gjithë djemtë e tu, Nako Breshanaj, Petro Breshanaj, Agron Breshanaj dhe Viktor Breshanaj, vajzat e tua Thëllëza, Vera dhe Trendelina, si dhe gjithë familja, nipërit e mbesat, të kanë dashur thellësisht. Dashuria dhe sakrificë jote, por edhe dashuria e tyre për ty, janë një e vërtetë që nuk mund të harrohet kurrë.

Në këtë përkujtim të gjashtëmujorit, bashkohemi edhe në kujtimin e hallë Eftalisë, xhaxha Fatoshit dhe gjyshit Gani, të cilët mbeten të paharruar në kujtesën e familjes.

Në këtë ditë përkujtimi, bashkohet me dhimbjen dhe respektin e familjes edhe Shoqata “Kallarati”, si dhe të gjithë ata që e njohën dhe e vlerësuan nënë Feriden për mirësinë, thjeshtësinë, forcën dhe dashurinë e saj.

U prehsh në paqe, nëna jonë e dashur! Dashuria për ty nuk do të shuhet kurrë.

IN MEMORIAM

NDAHET PARA KOHE NGA JETA LADI JAHO KONDAJ

Më 16 prill 2026, u nda para kohe nga jeta në moshën 60 - vjeçare, Ladi Jaho Kondaj. Kjo ndarje e parakohshme dhe krejt e papritur tronditi familjen, të afërmit dhe gjithë bashkëfshatarët, duke lënë pas një dhimbje të rëndë që fjalët e kanë të vështirë ta shprehin. Ladi ishte rritur me mund e sakrificë nga prindërit e tij, Jaho dhe Xhurxhi Kondaj (ndarë nga jeta). Ai ndërtoi familjen e tij me bashkëshorten Meritën, vajzën e Njazi Xhaferajt, dhe ishte baba i tre djemve, të cilëve u la dashurinë, kujtimin dhe emrin e tij të mirë.

Ai do të kujtohet si një njeri i urtë, punëtor, i ndershëm dhe i respektuar nga të gjithë. Ishte nga ata njerëz që nuk bënin zhurmë, por linin gjurmë të mira në jetën e përditshme të fshatit. Ai ishte aktiv dhe i përkushtuar në jetën shoqërore të fshatit, në grupin artistik dhe në çdo veprimtari ku kërkohej prania e tij.

Ikja e tij e shpejtë dhe krejt e papritur është një humbje e madhe për bashkëshorten Meritën, për tre djemtë: Xhulion, Eltonin dhe Leonardin, për motrat: Alimenë, Esmënë, Athinanë dhe Markelën, për vëllezërit: Yllin dhe Bedriun, për gjithë fisin Kondaj dhe për mbarë Kallaratin.

Në këto çaste të rënda dhimbjeje, Kryesia e Shoqatës “Kallarati” i shpreh familjes Kondaj, bashkëshortes, djemve, motrave, vëllezërve dhe gjithë të afërmeve ngushëllimet më të sinqerta e më të thella.

Qoftë i lehtë dheu i vendlindjes për të! Qoftë i paharruar kujtimi i tij! U prehtë në paqe!



Kryesia e Shoqatës “Kallarati” u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. Qofshin të paharruar!

15 "TAKIMI I BREZAVE" NË KALLARAT

15 GUSHT 2026

Të dashur kallaras, kudo që ndodheni, si edhe miq e dashamirës të Kallararit!

Kryesia e Shoqatës "Kallarati", në bashkëpunim me Këshillin e Fshatit të Kallararit, pas marrjes së mendimeve nëpërmjet fejsbukut, njofton të gjithë kallarasit, brenda dhe jashtë vendit, si edhe miqtë dhe dashamirësit e fshatit, se "Takimi i Brezave" për vitin 2026 do të zhvillohet ditën e shtunë, më 15 gusht, ora 19:30, në sheshin kryesor pranë lapidarit, në Morrez, Kallararat.

Ky organizim i përvitshëm, tashmë i kthyer në një traditë të bukur bashkimi, synon të mbledhë së bashku brezat, familjet, fiset dhe miqtë e Kallararit, në një mbrëmje me vlera shoqërore, qytetare dhe atdhetare.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet është e lirë për të gjithë, jo vetëm kallaras, por edhe për miq e dashamirës të tyre.

Organizimi do të bëhet sipas dëshirës, në bazë familjesh, fisesh apo shoqërisht, ndërsa porositë për ambiente private dhe shërbim do të kryhen individualisht, njësoj si në vitet e mëparshme.

Të gjithë ata që dëshirojnë të japin kontributin e tyre në mbarëvajtjen dhe organizimin e këtij takimi, qoftë në formë materiale apo financiare, janë të mirëpritur të komunikojnë me Kryetarin dhe Sekretarin e Shoqatës "Kallarati", me qendër në Vlorë, z. Kastriot Karabollë dhe z. Hasan Mehmetaj, si edhe me Kryetarin e Këshillit të Fshatit, z. Bashkim Davacaj.

Mbarëvajtja e këtij takimi kërkon edhe sigurimin në kohë të orkestrës, si edhe të një ose dy këngëtarëve, të cilët, si çdo vit, i japin gjallëri dhe kënaqësi kësaj mbrëmjeje. Ky mbetet një nga aspektet që do të zgjidhet në muajt në vijim nga Kryesia e Shoqatës, ndërkohë që çdo individ apo grup individësh janë të mirëpritur të japin mendime dhe kontributin e tyre financiar. Gjithashtu, do të vlerësohej edhe mbështetja e Bashkisë Himarë, e cila vitet e fundit është treguar mbështetëse e aktiviteteve të tilla në të gjitha fshatrat e Njësisë Administrative Horë - Vranishtit.

Në frymën e bashkimit dhe të respektit të përbashkët, ju ftojmë të bëheni pjesë e këtij takimi të rëndësishëm për fshatin tonë.



**MIRË SE TË VINI NË
"TAKIMIN E BREZAVE" 2026!
KRYESIA E SHOQATËS
"KALLARATI" DHE KËSHILLI I
FSHATIT TË KALLARATIT**

Ec ngado KALLARATIN mos e harro!

THIRRJE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR BOTIMIN E LIBRIT HISTORIK: KALLARATI (Histori e dokumentuar)

Të dashur bashkëfshatarë kallاراتas, miq dhe dashamirës të Kallararit!

Pas një pune të gjatë disa vjeçare dhe një konsultimi të gjerë me bashkëfshatarët, grupi i punës nën drejtimin e Prof. Dr. Rami Memushaj, me përkushtim, përgjegjësi dhe dashuri për vendlindjen, ka përfunduar përgatitjen e historikut të Kallararit, i cili tashmë është gati për botim.

Ky libër “Kallarati” (Histori e dokumentuar), i mbështetur në fakte, dokumente arkivore, dëshmi dhe dorëshkrime të lëna nga bashkëfshatarët tanë ndër vite, pasqyron në mënyrë kronologjike historinë e Kallararit, që nga kohët më të hershme kur përmendet emri Kallarati, e deri në ditët e sotme. Në libër trajtohet rrugëtimi historik i fshatit, nga koha kur ai ka qenë i vendosur në Kunjovë, më pas në Pilingri dhe, më vonë, në vendbanimin e sotëm, të shtrirë në tri lagjet: Morrez, Qafa e Ubavit dhe Basha. Historiku mbështetet gjithashtu edhe në punimet e mëparshme, përfshirë historikun e vitit 1965, botime të mëvonshme, gazetën “Kallarati”, historikun e botuar nga Enver Strati, si dhe në materiale të vlefshme të ruajtura nga brezat.

Siç është bërë e ditur edhe më parë, libri është menduar të botohet në 400 kopje dhe të shpërndahet për bashkëfshatarët tanë dhe jo vetëm, në mbrëmjen e “Takimit të Brezave”, më 15 gusht 2026, në Kallarati.

Përveç asaj mbrëmjeje, historiku do të ketë edhe pika të tjera shpërndarjeje në Kallarati, Vlorë, Fier, Durrës, Tiranë dhe kudo ku jetojnë kallاراتas.

Libri do të shitet jo me vlerën e tij reale, por me një çmim simbolik prej 5 mijë lekësh të vjetra, me qëllim që të jetë sa më i mundshëm për çdo familje kallاراتase.

Për të mundësuar botimin sa më shpejt të këtij libri me rëndësi të veçantë për historinë dhe kujtesën tonë të përbashkët,

nevojitet mbështetje financiare për likuidimin e shtëpisë botuese, në vlerën prej 1.5 milion lekësh të vjetra.

Për këtë arsye, Kryesia e Shoqatës “Kallarati” u bën thirrje të gjithë atyre që kanë mundësi dhe dëshirë të kontribuojnë, të japin ndihmën e tyre financiare duke i dorëzuar kontributet si më poshtë:

- . Në Tiranë, te Bako Xhaferaj;
- . Në Vlorë, te Kastriot Karabolli;
- . Në Kallarati, te Erges Hoxhaj;
- . Në Fier, te Edmond Strati;
- . Në Durrës, te Gjergji Dautaj;
- . Në Sarandë dhe Delvinë te Pajtim Tozaj;

Për bashkëfshatarët dhe dashamirësit që jetojnë jashtë vendit, kontributet mund të dërgohen me Ëestern Union te një nga anëtarët e Kryesisë së Shoqatës.

Të gjitha lekët e grumbulluara do të administrohen nga një grup i caktuar i Kryesisë së Shoqatës dhe do të bëhen publike me transparencë të plotë në faqen e Facebook-ut të Shoqatës “Kallarati”, si dhe në gazetën “Kallarati”.



Kryeredaktor:
Lefter HYSAJ

Redaksia e Gazetës:

Anëtarë:

Prof. dr. Rami

MEMUSHAJ,

Hiqmet MEÇAJ,

Çize XHAFERAJ,

Eleni MEMUSHAJ,

Besnik GJONBRATAJ,

Riza MEMUSHAJ,

Selo QEJVANI.

Redaktor/korrektor:

Prof. Dr. Rami Memushaj

Graphic Designer:

A. Hysaj